

Parandalimi i Radikalizmit dhe Ekstremizmit të Dhunshëm:
Mësimet nga Shembujt Pozitivë të Komunave të
Podujevës dhe Suharekës

Ky raport i politikave është pjesë e programit të Konzortiumit të OJQ-ve (ATRC, KIPRED, BIRN, SPRC, KCBS dhe D+) “Me Demokraci Pjesëmarrëse për një Kosovë pa Radikalizëm”.

Consortium: "With Participatory Democracy for a Kosovo without Radicalization" | Konzorciumi: "Me Demokraci Pjesëmarrëse për një Kosovë pa Radikalizëm"



Përgatitur nga: Agon Demjaha

Edituar nga: Lulzim Peci

Asistent i hulumtimit: Blend Zyrapi

Asistentë në mbledhjen e të dhënave kuantitative: Diedon Nixha dhe Valdrin Ukshini

Copyright © 2018, KIPRED. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk bën të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem rrikthyes, apo të bartet, në çfarëdo qoftë forme dhe me çfarëdo qoftë pajisjesh, elektronike, mekanike, fotokopjuese, regjistruese, apo të tjera, pa lejen paraprake me shkrim nga botuesi. Luteni të kontaktoni: info@kipred.org apo: +381 38 542 778.

Botuar nga:



Instituti Kosovar për Hulumtim dhe Zhvillim të Politikave (KIPRED)

Rr. Major Mehmet Bushi, H.III. No.1

10 000 Prishtinë, Kosovë

Telefoni dhe faksi: +381 38 542 778

Përmbajtja:

Përmbledhje Ekzekutive	5
Hyrje	10
Krahasimi i Karakteristikave Socio-Ekonomike	13
Analizë: Pse nuk ka Ekstremizëm të Dhunshëm në Komunitet e Podujevës dhe Suharekës	34
Përfundime dhe Rekomandime	52

Përmbledhje Ekzekutive

Pas sulmeve terroriste në disa qytete të Evropës, parandalimi i radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm është bërë prioritet në agjendat politike të shumicës së qeverive në botë. Në vitin 2011, Kosova u rangua ndër vendet me përqindjen më të lartë për kokë të banorëve për nga numri i luftëtarëve të huaj në luftërat në Siri dhe Irak. Hulumtimet e shumta të realizuara ndërkohë poashtu flasin për një nivel relativisht të lartë të radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm në rajone të caktuara të vendit. Për deri sa në disa komuna, sikurse në ato të Kaçanikut dhe Hanit të Elezit është evidentuar një numër relativisht i lartë i luftëtarëve të huaj, në ato të Podujevës dhe Suharekës ky numër është tejet i vogël apo joegzistues. Realiteti i njejtë është edhe sa i përket nivelit të radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm. Prandaj, qëllimi kryesor i këtij punimi ishte të hulumtojë faktorët që kontribuan në parandalimin e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm në këto dy komuna.

Për vite me rradhë, faktorët socio-ekonomikë janë konsideruar ndër shkaktarët kryesorë të radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm në Kosovë. Me qëllim të analizës së ndikimit të faktorëve socio-ekonomikë në shfaqjen e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, gjatë hulumtimit është bërë krahasimi i këtyre të dhënave për komunat e Podujevës dhe Suharekës me nivel të ultë të radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm dhe atyre të Kaçanikut dhe Hanit të Elezit, ku niveli i këtyre fenomeneve negative është mjaft i lartë. Përveç qëllimit për të vërtetuar se vallë ka dallime të konsiderueshme të këtyre karakteristikave mes këtyre dy grupeve të komunave, hulumtimi poashtu ka tentuar të vërtetojë nëse ekziston një korrelacion midis këtyre karakteristikave dhe shfaqjes së radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm. Për këtë qëllim janë analizuar të dhënat për: popullatën dhe lëvizjet demografike, nivelin e arsimit në komuna, religjionin duke përfshirë objektet religjioze dhe klerikët fetarë, personat që kanë marrë pjesë në luftrat në Siri dhe Irak, nivelin e kriminalitetit, gjendjen ekonomike, si dhe buxhetin komunal, me theks të posaçëm në shpenzimet kapitale si dhe shpenzimet dhe subvencionet për rini. Grupmohës prej 15 deri 29 vjet i është kushtuar një vëmendje e veçantë sepse janë pikërisht të rinjtë e kësaj moshe ata/ato që kanë qenë më së shumti të prekur nga dukuria e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm.

Krahasimi i të gjitha këtyre të dhënave socio-ekonomike për të katër komunat ka treguar se nuk ka dallime të mëdha në asnjërin nga kategoritë e të dhënave të analizuarra mes komunave të Podujevës dhe Suharekës në njërin anë, dhe atyre të Kaçanikut dhe Hanit të Elezit, në anën tjetër. Rrjedhimisht, është përfunduar se nuk ekziston ndonjë korrelacion i qartë midis këtyre karakteristikave socio-ekonomike dhe nivelit të shfaqjes së radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm në këto katër komuna. Këto rezultate e kanë sfiduar qartë paradigmen socio-ekonomike të shpjegimit të shfaqjes së mostolerancës fetare dhe ekstremizmit të dhunshëm, por nuk kanë dhënë përgjigje në pyetjen - përse në komunat e Podujevës dhe Suharekës niveli i radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm është shumë më i ulët se në disa komuna të tjera? Për t'ju përgjigjur kësaj pyetje është shtruar nevoja për një analizë më të thellë e cila i merr parasysh rrethanat specifike të këtyre dy komunave.

Në bazë të kësaj analize mund të përfundohet se faktori kryesor që ka kontribuar në parandalimin e shfaqjes së radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm në këto dy komuna është veprimi i drejtë dhe i duhur nga ana e Këshillit të Bashkësisë Islame (KBI). Në të dy rastet, KBI-të në fjalë që nga fillimi i kanë rezistuar instalimit të organizatave dhe individëve që kanë insistuar në predikimin e formave radikale të Islamit. Vazhdimisht është biseduar me popullatën, dhe atë jo vetëm në xhami gjatë namazit, por edhe gjatë tubimeve, nëpër shkolla dhe në medime. Janë demaskuar ideologjitë e këtilla radikale si të huaja dhe të dëmshme për shqiptarët në Kosovë. Rrjedhimisht, në këto dy komuna, shoqatat e këtilla edhe përkundër përpjekjeve sidomos gjatë fazës së hershme të pasluftës, në këtë komunë nuk kanë arritur të gjejnë terren të përshtatshëm për promovimin e formave radikale të predikimit të Islamit. Në të njëjtën kohë, në këto dy komuna këto organizata nuk kanë arritur të gjejnë numër të mjaftueshëm të bashkëpunëtorëve të brendshëm, siç ka ndodhur në komunat tjera në Kosovë. Njëkohësisht, mund të përfundohet se KBI-të në të dy komunat kanë treguar vëmendje të posaçme dhe guxim gjatë procesit të emërimit të imamëve. Përkundër kontestimeve dhe kundërshtimeve nga Kryesia Qendrore e Bashkësisë Islame të Kosovës (BIK), madje edhe tensioneve serioze në drejtimin KBI – BIK, KBI-të në të dy komunat kanë refuzuar emërimin e cilitdo imam apo nëpunës për të cilët kanë ekzistuar dëshmi se kanë qenë të involvuar në predikimin e formave radikale të Islamit. Poashtu, KBI-të komunale në Podujevë dhe Suharekë vazhdimisht i kanë refuzuar ofertat e shumta nga organizatat e huaja për ndërtimin e xhamive të reja apo

rindërtimin e xhamive të shkatërruara gjatë luftës, në rast se ky proces i (ri)ndërtimit ka qenë i kushtëzuar me emërimin e imamëve të caktuar në këto xhami apo me insistimin që në këto objekte fetare të predikohen forma radikale të Islamit.

Poashtu, mund të konkludohet se numri më i madh i xhamive të reja të ndërtuara nuk është barometër i matjes së nivelit të radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm. Në këtë drejtim, shumë më e rëndësishme është se nga cilat organizata është financuar ndërtimi i xhamive të reja, a është bërë ky ndërtim me leje të KBI-së komunale dhe vallë këto organizata e kanë kushtëzuar ndërtimin e xhamive me emërimin e imamëve të caktuar apo kanë insistuar që në këto objekte fetare të predikohen forma radikale të Islamit. Njëkohësisht, element mjaft i rëndësishëm është fakti se vallë KBI-të në nivel komunal kanë bashkëpunuar me përfaqësuesit e “shoqërisë civile religjioze” me karakter radikal apo i kanë kundërshtuar shoqatat e tilla dhe kanë refuzuar çfarëdo bashkëpunimi me to. Nga ana tjetër, nga analiza e bërë, mund të konstatohet se nuk qëndron spjegimi nga disa qarqe se arsyeja pse radikalizmi dhe ekstremizmi i dhunshëm nuk ka arritur të lëshojë rrënjë në rajonin e Llapit ka të bëjë me faktin se popullata në atë pjesë të Kosovës ka qenë gjithmonë më fetare se qytetarët në pjesët tjera të vendit. Marrë këtë parasysh, gjithsesi arsyet për mos shfaqjen e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm në Komunën e Podujevës, por edhe në ato të Suharekës banorët e së cilës tradicionalisht ka qenë më pak fetarë, duhet kërkuar tek faktorë të tjerë.

Në bazë të hulumtimit mund të përfundohet se një nga faktorët tjerë të rëndësishëm për parandalimin e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm në këto dy komuna ka qenë edhe bashkëpunimi i suksesshëm mes autoriteteve lokale fetare, pushtetit lokal dhe policisë. Ekzistojnë shembuj të shumtë kur përmes koordinimit të përbashkët të KBI-së, autoriteteve lokale dhe policisë është penguar ndërtimi i ndonjë xhamije pa leje, janë parandaluar veprimet e grupeve për predikim radikal të Islamit ose edhe janë burgosur pjesëtarët e këtyre grupeve. Sa i përket rolit të partive politike në parandalimin e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm situata në të dy komunat dallon deri diku. Në Komunën e Podujevës, përveç disa përjashtimeve të vogla, partitë politike gati aspak nuk kanë vepruar në parandalimin e këtyre dukurive negative dhe madje gjatë fushatave zgjedhore, me qëllim të sigurimit të votave, disa prej tyre kanë koketuar dhe bashkëpunuar me grupe dhe individë të caktuar që kanë qenë të involvuar në

përhapjen e formave radikale të Islamit. Nga ana tjetër, në Komunën e Suharekës partitë politike nuk kanë koketuar me grupe dhe individë që promovojnë forma radikale të Islamit me qëllim të sigurimit të votave. Përkundrazi, shpesh kanë qenë aktivisht të angazhuar në promovimin e tolerancës fetare dhe vlerave perëndimore qoftë në mënyrë individuale, qoftë përmes takimeve në Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi dhe diskutimeve lidhur me këto tema. Njëkohësisht, mund të konstatohet se bashkëpunimi lidhur me parandalimin e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm ka qenë në nivel të kënaqshëm edhe në relacionin mes mediave lokale dhe KBI-së në të dy komunat. Shpesh, përfaqësues të KBI-së janë paraqitur në mediumet lokale për të sqaruar dëmet e predikimeve radikale të Islamit që kanë tentuar të infiltrohen në territorin e komunës. Përmes debateve dhe ligjëratave këta përfaqësues fetarë kanë shpërndarë njohuri të sakta për Islamin dhe gjithashtu e kanë spjeguar të vërtetën lidhur me lëvizjet e reja me karakter radikal.

Mirëpo, ekzistojnë indikacione se kohëve të fundit situata në Komunën e Suharekës, por sidomos në atë të Podujevës, ka filluar të përkeqësohet sa i përket radikalizmit dhe ekstremizmit fetar. Ky realitet kryesisht ndërlihet me ndryshimet që janë bërë në KBI në kuadër të komunës, si dhe ndryshimeve në Rregulloren e BIK-ut lidhur me emërimin e imamëve në të gjitha komunat në Kosovë. Për deri sa para ndryshimeve të fundit të Rregullores, imamët në kuadër të komunës janë emëruar me propozim të drejtëpërdrejtë nga kryesia e KBI-së, me ndryshimet e fundit, të gjitha ingerencat për emërimin e imamëve nëpër komuna kanë kaluar në duart e BIK-ut. Marrë parasysh se në kryesinë e BIK-ut tanimë ka individë me pikëpamje radikale, ekziston rreziku që në të dy komunat, por edhe në mbarë Kosovën, të emërohen imamë të cilët predikojnë forma radikale të Islamit, të ndryshme nga format tradicionale tolerante karakteristike për Kosovën. Si pasojë, përkundër kundërshtimeve nga KBI-të, në të dy komunat tanimë janë bërë disa emërimet të imamëve të cilët propagojnë ideologjitë radikale të Islamit. Vazhdimi i një praktike të këtillë të emërimit të imamëve të radikalizuar nga ana e BIK-ut, padyshim se mund të çojë deri te rritja e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm në këto komuna. Një shpresë në këtë drejtim është fakti se qytetarët në të dy komunat nuk i kanë përkrahur tentativat për aktivitete që çojnë drejt radikalizmit, dhe madje drejtëpërdrejtë kanë ndihmuar në identifikimin e grupeve dhe individëve që kanë tentuar të predikojnë forma radikale të Islamit. Mirëpo, mbetet diskutabile se në ç'mënyrë do të sillen popullata lokale sikur përfaqësuesit e KBI-së në të dy komunat prej

fillimit të mos ishin angazhuar maksimalisht në parandalimin e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm.

Rekomandime:

- Institucionet qeveritare, udhëheqësit politikë dhe ata fetarë, duhet që të prezantojnë një diskurs të përbashkët publik në Kosovë i cili do të promovonte format tradicionale tolerante të Islamit dhe do të dënonte format e huaja radikale që padyshim çojnë drejt radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm.
- Bashkësia Islame e Kosovës duhet ta ndërprejë emërimin e imamëve radikalë nëpër xhamitë e saj. Gjatë emërimit të imamëve, BIK-u duhet të bashkëpunojë ngushtë me përfaqësuesit e KBI-ve komunale sidomos në ato komuna si ajo e Podujevës dhe Suharekës që deri më tani kanë shfaqur nivele të ulta të radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm.
- Duhet të sigurohet një bashkëpunim intenziv dhe i vazhdueshëm në mes të përfaqësuesve të pushtetit lokal, KBI-ve komunale dhe policisë për parandalimin e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm në nivel të çdo komune.
- Autoritetet e pushtetit lokal në bashkëpunim me pushtetin qendror duhet dukshëm t'i rrisin investimet kapitale dhe përkrahjen e kulturës, rinisë dhe sportit, veçanërisht ato për infrastrukturën dhe aktivitetet që ndërlidhen me rini.
- Partitë politike, si në nivelin qendror ashtu edhe në atë lokal, duhet të veprojnë bashkarisht në demaskimin e formave radikale të predikimit të Islamit dhe në luftimin e grupeve dhe individëve që i promovojnë format e tilla, dhe duke e respektuar lirinë e shprehjes dhe të drejtën e patjetërsueshme në besimin fetar, si e drejta elementare njerëzore.
- Sistemi i drejtësisë i Kosovës duhet të zbatojë vendosshmërisht kornizën ligjore (Kodin Penal) ndaj gjuhës së urrejtjes, për sa i përket urrejtjes fetare dhe etnike, si dhe predikimit të ekstremizmit.
- Mediumet elektronike në Kosovë, si në nivelin qendror ashtu edhe në atë lokal, duhet të ofrojnë skema programore që promovojnë tolerancë dhe bashkëjetesë fetare dhe mos t'ju japin hapësirë individëve të cilët përdorin gjuhën e urrejtjes ndër-fetare dhe ndër-etnike.

1. Hyrje

Radikalizmi dhe ekstremizmi i dhunshëm është bërë çështje qendrore në Evropë dhe në mbarë botën që nga sulmet në Madrid (2004), Londër (2005), Glasgow (2007) dhe Paris (janar dhe nëntor 2015).¹ Rrjedhimisht, parandalimi i radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm është bërë prioritet në agjendat politike të shumicës së qeverive në mbarë botën dhe padyshim paraqet mënyrën më efikase në përballimin e këtyre fenomeneve negative të çdo shoqërie. Në rend të parë, për arsye se në këtë mënyrë adresohen shkaqet kryesore të këtyre fenomeneve, në vend që të merremi me pasojat e tyre. Prandaj, në Evropë dhe në botë, janë përpiluar dhe po implementohen një varg projektesh të ndryshme ndër-shtetërore dhe regjionale për të eksploruar dhe zhvilluar strategji për parandalimin e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm.

Sot, koncepti i radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm është i lidhur kryesisht me agjenda anti-liberale, fundamentaliste, antidemokratike dhe regresive, dhe gjithnjë e më shumë ndërlidhet me Islamizmin radikal. Sipas Schmid-it, koncepti i radikalizmit mund të përshkruhet më së miri si diçka që angazhohet për ndryshim të gjerë politik, bazuar në bindjen se *status quo*-ja është e papranueshme, ndërkaq që në të njëjtën kohë është në dispozicion një alternativë rrënjësisht e ndryshme.² Në bazë të mjeteve që propozohen për të sjellë deri te një zgjidhje radikale sistem-transformuese për qeverinë dhe shoqërinë, disa autorë argumentojnë se radikalizmi i favorizon zgjidhjet që janë të dhunshme dhe jo demokratike dhe që më së miri arrihen përmes detyrimit dhe revolucionit.³ Duhet theksuar se qëndrimet radikale nuk rezultojnë domosdoshmërisht në sjellje të dhunshme. Sidoqoftë, kohët e fundit gjithnjë e më shumë po bëhet një ndërlidhje mes radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, dhe dy termat shpesh po përdoren si sinonime.

¹ Bombardimi i trenit në Madrid ka ndodhur me 11 mars 2004; eksplodimi i bombës në Londër ka ndodhur me 7 korrik 2005; sulmi në aeroportin ndërkombëtar të Glasgow-it ka ndodhur me 30 qershor 2007; të shtënat në zyret e Charlie Hebdo në Paris kanë ndodhur me 7 janar 2015; sulmet në Bataclan të Parisit kanë ndodhur me 13 nëntor 2015.

² See A. P. Schmid (ed.), *The Routledge Handbook of Terrorism Research*, London: Routledge, 2011, 679-80.

³ See Scruton, R., *A Dictionary of Political Thought*, London: Macmillan, 1996, 462.

Fatkeqësisht, viteve të fundit këto fenomene negative nuk e kanë anashkaluar as Kosovën. Gjatë pjesës më të madhe të historisë, Kosova është karakterizuar me një nivel të lartë të tolerancës dhe bashkëjetesës fetare. Në të kaluarën, radikalizmi dhe ekstremizmi i dhunshëm në Kosovë ishin kryesisht të lidhur me përkatësinë etnike dhe jo me ate fetare. Kjo ka qenë sidomos e vërtetë për shqiptarët e Kosovës të cilët u përkasin feve të ndryshme. Që nga procesi i rilindjes kombëtare shqiptare, shqiptarët në Kosovë i kanë dhënë përparësi shumë më të madhe përkatësisë së tyre etnike karahsuar me ate fetare. Si rezultat, shqiptaria e shoqëruar me bashkëjetesë fetare, përfaqëson elementin kryesor të nacionalizmit shqiptar në Kosovë. Prosesi i shpërbërjes së ish-Jugosllavisë dhe lufta për pavarësi (1989-1999) shënoi fazën e homogjenizimit më të fuqishëm të shqiptarëve të Kosovës. Karakteristikat kryesore të nacionalizmit shqiptar gjatë kësaj kohe ishin orientimi pro-perëndimor dhe bashkimi i përgjithshëm i shqiptarëve pavarësisht nga përkatësia e tyre fetare dhe sociale.⁴

Pas çlirimit dhe vendosjes së Administratës së Kombeve të Bashkuara (UNMIK) në vitin 1999, ngjashëm me vendet e tjera ish-komuniste, rigjallërimi i religjionit filloi edhe në Kosovë. Rrethanat e reja në mënyrë të pashmangshme shkaktuan një proces të transformimit dhe ridefinimit të pozitës së religjionit. Prezenca e Islamit dhe Krishterimit u bë e dukshme dhe më e theksuar në të gjitha sferat publike, duke filluar nga jeta personale deri te shoqëria e gjerë, përfshirë edhe politikën. Pasojat e luftës kishin krijuar rrethana të shumëta në vitet e para pas vitit 1999, duke ofruar një terren të frytshëm për fetarizimin e shoqërisë. Dezorientimi shoqëror, varfëria e lartë, ekonomia e dobët dhe vakumi politik e shndërruan Kosovën në tokë pjellore për rigjallërimin e religjionit. E tërë shoqëria kosovare shumë shpejt iu ekspozua një shumëllojshmërie të ideve konkurruese, të cilat në të njëjtën kohë ishin edhe liberale dhe konservative.⁵

Gjatë kësaj periudhe, popullata e Kosovës e rrënuar nga lufta iu ekspozua organizatave të ndryshme ndërkombëtare me bazë fetare të cilat u përhapën në gjithë vendin pas luftës. Nën maskën e ndihmës humanitare, këto organizata e shfrytëzuan pa mëshirë

⁴ Për një spjegim detaj lidhur me këtë çështje shih Demjaha, Agon, Peci, Lulzim, "What happened to Kosovo Albanians: The impact of religion on the ethnic identity in the state building-period." Policy Paper No. 1/16, Kosovar Institute for Policy Research and Development (KIPRED), qershor 2016.

⁵ Kursani, Shpend, "Report inquiring into the causes and consequences of Kosovo citizens' involvement as foreign fighters in Syria and Iraq," Kosovar Center for Security Studies, prill 2015, 59.

varfërinë dhe kushtet shoqërore të kosovarëve, veçanërisht në hapësirat rurale, duke dëmtuar seriozisht traditat kulturore të këtyre komuniteteve. Rrjedhimisht, organizatat e ndryshme nga shtetet e Gjirit Persik, por edhe Turqia, arritën të bëjnë përhapjen dhe përforcimin e doktrinafe fetare radikale të Islamit në gjithë Kosovën. Në këtë mënyrë, lojaliteti i shqiptarëve të Kosovës gjatë kësaj periudhe dalëngadalë është zhvendosur nga shqiptaria dhe shteti i Kosovës në një identitet fetar me karakter ekskluziv etno-religjioz, shpesh madje edhe me primesa të Islamit radikal.⁶ Prandaj, nuk ishte befasi që në vitin 2014, një numër mjaft i madh i luftëtarëve të huaj nga Kosova ju bashkangjitë luftrave në Siri dhe Irak. Në një moment, Kosova kishte rreth 300 luftëtarë që mernin pjesë në këto luftëra, shifër kjo që në të vërtetë paraqiste numrin më të lartë të luftëtarëve të huaj për kokë banori në Evropë. Për deri sa komunat e Kaçanikut dhe Hanit të Elezit e kishin numrin më të lartë të luftëtarëve të huaj, dy komuna – Podujeva dhe Suhareka – kishin një numër tejet të vogël dhe nuk kishin shfaqur shenja të radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm që ishte vërejtur në pjesët tjera të vendit.

Qëllimi i këtij punimi është të hulumtojë arsyet që kontribuan në parandalimin e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm në këto dy komuna. Shpresojmë se në këtë mënyrë, punimi do të ofrojë njohuri të dobishme në lidhje me parandalimin e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm në këto dy komuna, të cilat pastaj do të mund të përdoren për zbatimin e qasjeve të ngjashme edhe në komunat tjera në Kosovë në të cilat janë regjistruar nivele relativisht të larta të radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm. Pas këtij kapitulli hyrës, punimi vazhdon me kapitullin i cili i diskuton të dhënat socio-ekonomike të komunave të Podujevës dhe Suharekës. Ky kapitull poashtu ofron edhe një analizë krahasuese të të dhënave socio-ekonomike të këtyre dy komunave me ato të Kaçanikut dhe Hanit të Elezit të cilat kishin numrin më të lartë të luftëtarëve të huaj dhe ku janë vërejtur nivele relativisht të larta të radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm. Kapitulli tjetër pastaj tenton të shpjegojë pse në komunat e Podujevës dhe Suharekës nuk ka nivele të larta të radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm në krahasim me disa komuna të tjera në Kosovë. Së fundi, dokumenti nxjerr konkluzione mbi faktorët kryesorë të identifikuar që kanë penguar shfaqjen e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm në komunat e Podujevës dhe Suharekës

⁶ Demjaha dhe Peci, 2016, 59.

dhe gjithashtu ofron një numër rekomandimesh për zbatimin e këtyre përfundimeve në komunitat tjera të Kosovës.

2. Krahasimi i Karakteristikave Socio-Ekonomike


Deri vonë, faktorët socio-ekonomikë kanë shërbyer si argument kryesor për shpjegimin e shfaqjes së radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm në Kosovë. Përfundimet në punimin "Çfarë ndodhi me shqiptarët e Kosovës: Ndikimi i religjionit në identitetin etnik në periudhën e shtet-ndërtimit" të botuar nga KIPRED në qershor 2016, për herë të parë e kanë sfiduar seriozisht paradigmen socio-ekonomike të shpjegimit të intolerancës fetare dhe ekstremizmit të dhunshëm.⁷

Qëllimi i këtij seksioni është të bëjë një analizë krahasuese të karakteristikave të ndryshme socio-ekonomike ndërmjet dy komunave (Podujevë dhe Suharekë) të cilat nuk kanë treguar shenja të radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm dhe dy komunave me nivel relativisht të lartë të radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm (Kaçanik dhe Hani i Elezit). Një analizë e tillë krahasuese do të duhej të tregojë vallë ka dallime të konsiderueshme të këtyre karakteristikave midis këtyre dy grupeve të komunave, dhe a thua ekziston një korrelacion midis këtyre karakteristikave dhe shfaqjes së radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm.

Statistikat në përgjithësi flasin se grupmosha 15-29 vjet paraqet grupmoshën e cila më së shumti i ekspozohet radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm. Nga ana tjetër, sipas një raporti të botuar vitin e kaluar nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), shumica e luftëtarëve të huaj nga Kosova ose të atyre që kanë udhëtuar në Siri dhe Irak i takojnë pikërisht grupmoshës 21-30 vjet (shih Diagramin nr. 1).⁸ Për këtë arsye, fokusi parësor i kësaj analize është përqëndruar në mënyrë të posaçme pikërisht te të rinjtë e kësaj moshe.

⁷ Për detaje, shih Demjaha dhe Peci, 2016.

⁸ Xharra, Behar and Gojani, Nita, "Understanding Push and Pull Factors in Kosovo: Primary Interviews with Returned Foreign Fighters and their Families," Pristinë, Kosovë: Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), 2017. http://unckt.org/wp-content/uploads/2017/12/UNDP_Push-and-Pull-Factors_ENG.pdf



Për këtë qëllim, në kuadër të këtij hulumtimi janë përmbledhur të dhënat për: strukturën e popullatës dhe lëvizjet demografike, nivelin dhe strukturën e arsimit, kulturës dhe sportit, strukturën religjioze, përfshirë këtu edhe numrin e objekteve dhe të klerikëve fetarë, ekstremizmin e dhunshëm, nivelin e kriminalitetit, strukturën e popullatës sipas aktivitetit ekonomik, buxhetet komunale dhe mbështetjen që ato e ofrojnë për aktivitetet rinore.

2.1. Të Dhënat Socio-Ekonomike: Komuna e Podujevës

- **Struktura e popullatës dhe lëvizjet demografike**

Për nga popullsia, Podujeva bën pjesë në komunat mesatare në nivel të Kosovës. Të dhënat e regjistrimit të popullsisë në vitin 2011 tregojnë se kjo komunë ka patur 88.499 banorë, nga të cilët 39.20% kanë jetuar në qytet, ndërsa 60.80% në fshatra.⁹ Sipas përkatësisë etnike, 98.89% të banorëve të Podujevës janë shqiptarë, rreth 1% ashkali, ndërkaq pjesa tjetër i përket grupeve të tjera etnike. Raporti gjinor i popullatës është 50.8% meshkuj dhe 49.2% femra. Në kuadër të popullsisë së përgjithshme, grupmosha 15-29 është e përfaqësuar me 27.40%, ndërkaq që grupmosha 0-14 vjet përfshin 30.30%,

⁹ Popullsia e Kosovës dhe shtimi natyror për vitin 2017, Platforma Online ASK Data, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

dhe ajo me 30-80 vjet përfshin gjithsej 42.30%.¹⁰ Nga ana tjetër, regjistrimi i popullsisë në vitin 2011 tregon se pjesa dërmuese e të rinjëve në Komunën e Podujevës (73.7%) jeton në 78 fshatrat e komunës, ndërkaq, pjesa tjetër prej 26.3% jeton në qytet. Një analizë më e vëmendshme e lëvizjeve demografike të kësaj grupmoshe tregon se ekziston një lëvizje e vazhdueshme të të rinjëve nga fshati në qytet.¹¹

- **Niveli dhe struktura e arsimit, kulturës dhe sportit**

Të dhënat për popullatën e komunës së Podujevës për një periudhë mbi 10 vjeçare, sipas nivelit të arsimit dhe njohjes së lexim-shkrimit tregojnë se në 1000 banorë, 48 janë analfabetë, 112 nuk e kanë përfunduar asnjë nivel të shkollimit, 527 kanë përfunduar vetëm shkollën fillore, 304 kanë përfunduar shkollën e mesme, dhe 55 i kanë përfunduar studimet universitare dhe pas-universitare.¹²

Sipas statistikave të arsimit të Kosovës për vitin 2017/2018, Komuna e Podujevës ka gjithsej 62 institucione shkollore me 1,166 mësimdhënës dhe 19,732 nxënës, me një raport të shkollave prej 1.75 për 1000 banorë deri në moshën 19 vjeçare. Prej tyre, 57 janë shkolla fillore dhe të arsimit të mesëm të ulët, katër janë shkolla të arsimit të mesëm të lartë, ndërsa një është qendër e arsimit parashkollor.¹³ Duhet theksuar se në Komunën e Podujevës nuk funksionon asnjë institucion i arsimit të lartë as në sektorin publik e as në atë privat.

Nga ana tjetër, në komunën e Podujevës funksionojnë 18 klube sportive dhe 6 shkolla sportive të cilat i kanë në dispozicion 3 fusha të futbollit të madh, 17 fusha të futbollit të vogël me fushë me bar sintetik, një palestër dhe dy komplekse sportive. Poashtu, në komunë funksionon 1 bibliotekë, një qendër rinore dhe një teatër. Duhet theksuar se shumica e investimeve kapitale në nivel komunal fatkeqësisht nuk mjafton që të rinjtë e

¹⁰ Popullsia sipas moshave dhe llojit të vendbanimit, Platforma Online ASK Data, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

¹¹ Ibid.

¹² Popullsia e moshës mbi 10 vjeçare sipas nivelit të arsimit (2011), Platforma Online ASK Data, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

¹³ Statistikat e Arsimit në Kosovë 2017/2018, Agjencia e Statistikave të Kosovës, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Linku: <http://ask.rks-gov.net/media/4145/stat-e-arsimit-2017-2018-shqip.pdf>.

angazhuar në këto fusha t'i plotësojnë nevojat e tyre për t'i ushtruar aktivitetet e tyre të lira.¹⁴

- **Struktura religjioze**

Në aspektin e përkatësisë religjioze, 99.7% e popullatës së Komunës së Podujevës janë deklaruar se i përkasin besimit Islam, ndërkaq, nga pjesa tjetër, 0.01% janë deklaruar se i përkasin besimit katolik, 0.01% besimit ortodoks, dhe 0.25% të tjerëve përfshijnë personat pa përkatësi fetare, ata që nuk janë në dispozicion si dhe ata që kanë preferuar të mos përgjigjen.¹⁵

Duhet theksuar se në territorin e Komunës së Podujevës janë funksionale 41 xhami, tri prej të cilave janë në qytet dhe 38 ndodhen në fshatra. Numri i klerikëve islamë në gjithë komunën është 43.¹⁶ Këtu duhet theksuar që pas vitit 1999, në territorin e komunës së Podujevës janë renovuar 4 xhami të shkatërruara gjatë luftës, ndërkaq që në shërbim të besimtarëve islamë janë vënë edhe 18 xhami të reja të ndërtuara pas luftës.¹⁷ Raporti xhami për banorë në fshatra është 0.61 xhami për 1000 banorë, ndërkaq, në qytet 0.134 xhami për 1000 banorë. Në këtë komunë veprojnë edhe tri shoqata nën autoritetin e BIK-ut, ku një është humanitare, një e të rinjëve, dhe një e grave.¹⁸ Besimtarët katolikë në shërbim të tyre nuk kanë asnjë kishë katolike dhe asnjë klerik të Ispeshkvisë së Kosovës, edhe pse ekziston një kishë e cila nuk është funksionale.¹⁹ Nga ana tjetër, besimtarët protestantë e kanë një klerik dhe një shoqatë humanitare që është e ndërlidhur me komunitetin fetar, mirëpo nuk e kanë asnjë kishë protestante,²⁰ ndërkaq besimtarët ortodoksë aktualisht nuk kanë asnjë klerik apo kishë ortodokse,

¹⁴ Infrastruktura Kulturore dhe Sportive në Komunën e Podujevës. Të dhëna të dërguara nga Drejtoria e kulturës në Komunën e Podujevës, 2 gusht 2018.

¹⁵ Popullsia sipas gjinisë, religjionit dhe komunës 2011, Platforma Online ASK Data, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

¹⁶ Të dhëna nga Bashkësia Islame e Kosovës (BIK), 7 korrik, 2018.

¹⁷ Organisation for Security and Cooperation in Europe, Municipal Profile of Podujevë/Podujevo (2018) <https://www.osce.org/kosovo/13126?download=true>.

¹⁸ Të dhëna nga Bashkësia Islame e Kosovës (BIK), 7 korrik, 2018.

¹⁹ Organisation for Security and Cooperation in Europe, Municipal Profile of Podujevë/Podujevo (2018) <https://www.osce.org/kosovo/13126?download=true>.

²⁰ Të dhëna nga Kisha Protestante e Kosovës, 20 korrik 2018.

përveç një kishe jofunkcionale të renovuar në vitin 2010 e cila mbrohet nga Policia e Kosovës.²¹

- **Ekstremizmi i dhunshëm**

Komuna e Podujevës bën pjesë në një nga komunat me nivelin më të ulët të radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm. Sipas të dhënave të Policisë së Kosovës, nga komuna e Podujevës grupeve terroriste në Siri dhe Irak u është bashkangjitur vetëm një individ.²² Aktualisht, Policia nuk ka kurrëfarë informate për personin në fjalë, përveç faktit se ai nuk gjindet në territorin e komunës së Podujevës. Sipas burimeve të njëjta, edhe dy persona të tjerë kanë tentuar t'ju bashkohen grupeve që luftojnë në Siri, mirëpo ata janë parandaluar nga Policia e Kosovës.²³

Në bazë të intervistave me përfaqësuesit e Komunës, si dhe të BIK-ut dhe Policisë së Kosovës në nivel komunal, mund të përfundohet se ekziston një bashkëpunim dhe një koordinim i kënaqshëm mes këtyre institucioneve në drejtim të parandalimit të radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm në këtë komunë.²⁴ Në kuadër të komunës së Podujevës poashtu funksionojnë edhe tre këshilla që veprojnë në fushën e sigurisë, më saktësisht Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi, Komuniteti Lokal për Siguri Publike dhe Ekipi Veprues për Siguri në Bashkësi. Takimet në këto tre Këshilla janë të rregullta dhe në to marrin pjesë në mënyrë aktive të gjithë aktorët relevantë.²⁵ Vlen të përmendet se sipas të intervistuarve, rol të rëndësishëm në parandalimin e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm në këtë komunë ka luajtur edhe vetë popullata në gjithë territorin e komunës meqenëse ajo nuk i ka përkrahur tentativat për aktivitete që çojnë drejt radikalizmit dhe nuk i ka pranuar individët që kanë tentuar të mirren me veprime të tilla. Aktualisht në kuadër të komunës nuk vepron asnjë OJQ që propagon forma më radikale të Islamit. Në të kaluarën ka pasur tentative të tilla, kryesisht nga organizata që

²¹ Organisation for Security and Cooperation in Europe, Municipal Profile of Podujevë/Podujevo (2018) <https://www.osce.org/kosovo/13126?download=true>.

²² Të dhëna nga Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun, Policia e Kosovës, 27 korrik 2018.

²³ Intervistë me Zt. Bekim Bislimi, Komandant i Policisë në Komunën e Podujevës, 19 tetor 2018.

²⁴ Intervistat me Zt. Agim Veliu, Kryetar i Komunës së Podujevës (9 gusht 2018), Imamin 1 në Komunën e Podujevës (9 gusht 2018) dhe Zt. Bekim Bislimi, Komandant i Policisë në Komunën e Podujevës (19 tetor 2018).

²⁵ Intervistë me Zt. Bekim Bislimi, Komandant i Policisë në Komunën e Podujevës, 19 tetor 2018.

kanë shpërndarë ndihma apo kanë ndihmuar financiarisht, mirëpo përfaqësuesit e këtyre organizatave janë larguar me kërkesë të KBI-së komunal meqenëse kanë vepruar jashta rregullave të BIK-ut.²⁶

- **Niveli i kriminalitetit**

Statistikat për nivelin e kriminalitetit në Komunën e Podujevës tregojnë që brenda vitit të kaluar (2017) në këtë Komunë janë kryer 825 vepra penale,²⁷ domethënë, 9.9 vepra penale për 1000 banorë, shifër kjo që e pasqyron një nivel mesatar të kriminalitetit. Pjesa më e madhe e veprave penale hyjnë në kategoritë e veprave kundër pasurisë (474), dhe të veprave kundër jetës dhe trupit (182).²⁸

- **Struktura e popullatës sipas aktivitetit ekonomik**


Të dhënat statistikore (2011) për Komunën e Podujevës tregojnë se nga 58,700 persona të moshës mbi 15 vjet, vetëm 36% janë ekonomikisht aktivë, ndërkaq ekonomikisht joaktivë janë deklaruar 64% prej tyre. Nga ana tjetër, nga popullsia aktive e moshës mbi 15 vjet, vetëm 50.4% prej tyre janë të punësuar, 3,38% jetojnë me ndihma sociale dhe 5.92% janë të varur nga pensioni si burim kryesor i jetesës.²⁹ Struktura e të punësuarve sipas nivelit të arsimit për gjithë popullatën në Komunën e Podujevës, si dhe për grupmoshën 15-29 vjet të popullatës është paraqitur në diagramet nr. 2 dhe nr. 3.

²⁶ Ibid.


²⁷ Të dhëna nga Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun, Policia e Kosovës, 3 gusht 2018.

²⁸ Ibid.

²⁹ Popullsia e moshës 15 vjeç e mbi sipas statusit të aktivitetit aktual (2011), Platforma Online ASKDATA, Agjencia e Statistikave të Kosovës.



Diagrami nr.2: Struktura e të punësuarve sipas nivelit të arsimit për gjithë popullatën



Diagrami nr.3: Struktura e të punësuarve sipas nivelit të arsimit për grup-moshën 15-29 vjet

Ndërkaq, sa i përket qytetarëve që nuk janë ekonomikisht aktivë, duhet theksuar se 22.38% e tyre si arsye për këtë e deklarojnë vijimin e shkollimit, 40.82% deklarohen që kujdesen për familjen apo shtëpinë, ndërsa 3.46% përmendin arsye të tjera. Këtu duhet të ceket se 3.38% e popullatës janë në gjendje ekonomike të rëndë, duke jetuar nga ndihmat sociale, ndërkaq, 5.92% si burim kryesor të jetesës i kanë pensionet.³⁰


³⁰ Ibid.

- **Buxheti Komunal dhe mbështetja për aktivitetet rinore**

Për nga buxheti total Komuna e Podujevës rangohet si komuna e shtatë në Kosovë (pas Prishtinës, Prizrenit, Ferizajit, Pejës, Gjilanit dhe Gjakovës) dhe për vitin fiskal 2018, ky buxhet e kap shumën prej 21.372 milion Euro. Të hyrat në buxhet janë kryesisht nga dhëniet qeveritare që përbëjnë rreth 91.56% të totalit të tij, ndërkaq, rreth 8.4% të pjesës së mbetur Komuna i gjeneron nga të hyrat vetanake. Ngjashëm me komunitat tjera, edhe në atë të Podujevës pagat dhe mëditjet mbesin kategoria më e lartë me rreth 56% të buxhetit total. Kategoria e mallrave dhe shërbimeve bën pjesë me rreth 9%, ndërkaq, pjesa që i dedikohet investimeve kapitale është 30.36% e shumës totale.³¹

Nëse buxhetin e analizojmë në raport me investimet kapitale dhe përkrahjen e kulturës, rinisë dhe sportit, në veçanti me infrastrukturën dhe aktivitetet që ndërlidhen me rini, shihet që buxheti nuk e përfaqëson në asnjë mënyrë këtë grup të popullatës (grupmosha 15-29 vjet), që e paraqet 27.40% të popullatës së Komunës së Podujevës.

Kështu, në buxhetin për vitin 2018, vetëm 1.3% (282,047 Euro) të buxhetit total parashihet të shpenzohet ashtu që të ketë impakt tek të rinjtë, dhe kjo është e kategorizuar në tërësi në kuadrin e shpenzimeve kapitale dhe subvencioneve, me një pjesëmarrje të tërësishme prej gjithsej 4% të këtyre shpenzimeve. Duhet theksuar se pjesa më e madhe e këtyre fondeve prej 79% është paraparë për shpenzime kapitale, ndërkaq 21% për subvencione dhe transfere.³²



³¹ Ligji për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018, Ministria e Financave, <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/668E7D87-490C-4229-881B-E66CE614F4C1.pdf>.

³² Ibid.

2.2. Të Dhënat Socio-Ekonomike: Komuna e Suharekës

- **Struktura e popullatës dhe lëvizjet demografike**

Për nga popullsia, krahasuar me komunat tjera, Suhareka bën pjesë në komunat mesatare në nivel të Kosovës. Të dhënat e regjistrimit të popullsisë në vitin 2011 tregojnë që kjo komunë ka patur 59.722 banorë, nga të cilët vetëm 17.45% kanë jetuar në qytet, ndërsa 82.55% në fshatra.³³ Sipas përkatësisë etnike, 96.56% të banorëve të komunës së Suharekës janë shqiptarë, rreth 0.8% ashkali, ndërkaq pjesa tjetër i përket grupeve të tjera etnike.³⁴ Raporti gjinor i popullatës në kuadër të komunës është 49.36% meshkuj dhe 50.64% femra.

Meqenëse grupmosha 15-29 paraqet grupmoshën e cila më së shumti i ekspozohet radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, atëherë është e logjikshme që edhe fokusi parësor i kësaj analize të përqëndrohet pikërisht në të rinjtë e kësaj moshe. Në kuadër të popullsisë së përgjithshme, ky grup është i përfaqësuar me 28.10%, ndërkaq që grupmosha 0-14 vjet përfshin 29.20%, dhe ajo me 30-80 vjet përfshin gjithsej 42.70%.³⁵ Nga ana tjetër, regjistrimi i popullsisë në vitin 2011 tregon se të rinjtë në Komunën e Suharekës jetojnë shumë më shumë në 42 fshatrat e komunës (82.40%), ndërkaq, vetëm një pjesë e vogël (17.60%) jeton në qytet. Një analizë më e vëmendshme e lëvizjeve demografike të kësaj grupmoshe tregon se ekziston tendenca e një lëvizje të vazhdueshme të të rinjëve nga fshati në qytet.³⁶

- **Niveli dhe struktura e arsimit, kulturës dhe sportit**

Të dhënat për popullatën e komunës së Suharekës për një periudhë mbi 10 vjeçare, sipas nivelit të arsimit dhe njohjes së lexim-shkrimit tregojnë se në 1000 banorë, 41 janë analfabetë, 94 nuk e kanë përfunduar asnjë nivel të shkollimit, 613 kanë përfunduar

³³ Popullsia e Kosovës dhe shtimi natyror për vitin 2017, Platforma Online ASK Data, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

³⁴ Popullsia sipas përkatësisë etnike 2011, Platforma Online ASK Data, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

³⁵ Popullsia sipas moshave dhe llojit të vendbanimit, Platforma Online ASK Data, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

³⁶ Ibid.

vetëm shkollën fillore, 230 kanë përfunduar shkollën e mesme, dhe 61 i kanë përfunduar studimet universitare dhe pas-universitare.³⁷

Sipas të dhënave të Drejtorisë për Arsim të Komunës së Suharekës, në kuadër të komunës funksionojnë gjithsej 45 institucione shkollore me 839 mësimdhënës dhe 12,699 nxënës, me një raport të shkollave prej 1.88 për 1000 banorë deri në moshën 19 vjeçare. Prej tyre, 41 janë shkolla fillore dhe të arsimit të mesëm të ulët, tri janë shkolla të arsimit të mesëm të lartë, ndërsa një është qendër e arsimit parashkollor.³⁸

Ngjashëm me Komunën e Podujevës, edhe në atë të Suharekës nuk funksionon asnjë institucion i arsimit të lartë qoftë në sektorin publik, qoftë në atë privat. Nga ana tjetër, në komunën e Suharekës funksionojnë 21 klube sportive, një bibliotekë, 3 shtëpi të kulturës, 4 shoqëri kulturore-artistike dhe një qendër e rinisë. Mirëpo, siç do të shihet më vonë, shumica e investimeve kapitale nuk mjafton që të rinjtë e angazhuar në këto fusha t'i plotësojnë nevojat e tyre për t'i ushtruar aktivitetet e tyre të lira.³⁹

- **Struktura religjioze**

Në aspektin e përkatësisë religjioze, 98.3% e popullatës së Komunës së Suharekës janë deklaruar që i përkasin besimit islam, ndërkaq, nga pjesa tjetër, 0.6% janë deklaruar që i përkasin besimit katolik, 0.01% besimit ortodoks, dhe 1% të tjerëve përfshijnë personat pa përkatësi fetare, ata që nuk janë në dispozicion si dhe ata që kanë preferuar të mos përgjigjen. Është interesant të theksohet se në komunën e Suharekës kemi një numër më të madh se zakonisht të personave që preferojnë të mos përgjigjen rreth përkatësisë së tyre religjioze, respektivisht 467 persona apo 0.8% të qytetarëve i përkasin kësaj kategorie.⁴⁰

Duhet theksuar se në territorin e Komunës së Suharekës janë funksionale 24 xhami, një prej të cilave është në qytet dhe 23 ndodhen në fshatra. Numri i klerikëve islamë në

³⁷ Popullsia e moshës mbi 10 vjeçare sipas nivelit të arsimimit (2011), Platforma Online ASK Data, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

³⁸ Drejtoria për Arsim, Komuna e Suharekës, 15 nëntor 2018.

³⁹ Informata nga Drejtoria për Kulturë, Rini, Sport dhe Mërgatë, Komuna e Suharekës, 15 nëntor 2018.

⁴⁰ Popullsia sipas gjinisë, religjionit dhe komunës 2011, Platforma Online ASK Data, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

gjithë komunën është 26.⁴¹ Këtu duhet theksuar që pas vitit 1999, në territorin e komunës së Suharekës janë renovuar 14 xhami të shkatërruara gjatë luftës, ndërkaq që pas luftës në shërbim të besimtarëve islamë janë vënë edhe 5 xhami të reja.⁴² Raporti xhami për banorë në fshatra është 0.47 xhami për 1000 banorë, ndërkaq, në qytet ky raport është vetëm 0.096 xhami për 1000 banorë. Në këtë komunë veprojnë edhe tri shoqata nën autoritetin e BIK-ut, ku një është humanitare, një e të rinjëve, dhe një e grave.⁴³ Besimtarët katolikë në shërbim të tyre e kanë një kishë katolike në fshatin Sallagrazdë që është në përdorim. Nga ana tjetër, besimtarët protestantë poashtu e kanë në dispozicion një kishë, si dhe një klerik dhe një shoqatë humanitare që është e ndërlidhur me komunitetin fetar.⁴⁴ Duhet theksuar se besimtarët ortodoksë aktualisht nuk kanë asnjë klerik apo kishë ortodokse, meqenëse të gjashtë kishat e tilla janë shkatërruar në qershor të vitit 1999 dhe nuk janë renovuar asnjëherë.⁴⁵

- **Ekstremizmi i dhunshëm**

Komuna e Suharekës bën pjesë në një nga komunat me nivelin më të ulët të radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm në mbarë Kosovën. Sipas të dhënave të Policisë së Kosovës, nga komuna e Suharekës grupeve terroriste në Siri dhe Irak nuk u është bashkangjitur anjë individ.⁴⁶ Poashtu nuk ekzistojnë të dhëna lidhur me individët të cilët në të kaluarën kanë tentuar t’ju bashkangjiten grupeve të tilla në Siri dhe Irak dhe janë parandaluar për të bërë një veprim të tillë.⁴⁷

Në bazë të intervistave me përfaqësuesit e Komunës, si dhe të BIK-ut dhe Policisë së Kosovës në nivel komunal, mund të përfundohet se ekziston një bashkëpunim dhe një koordinim shumë efektiv mes këtyre institucioneve në drejtim të parandalimit të

⁴¹ Të dhëna nga Bashkësia Islame e Kosovës (BIK), 7 korrik, 2018.

⁴² Organisation for Security and Cooperation in Europe, Suharekë/Suva Reka Municipal Profile (2018), 10 October 10 October 2018, <https://www.osce.org/kosovo/13131?download=true>.

⁴³ Të dhëna nga Bashkësia Islame e Kosovës (BIK), 7 korrik, 2018.

⁴⁴ Të dhëna nga Bashkësia e Kishës Protestante të Kosovës, 20 korrik 2018.

⁴⁵ Organisation for Security and Cooperation in Europe, Municipal Profile of Podujevë/Podujevo (2018) <https://www.osce.org/kosovo/13126?download=true>.

⁴⁶ Të dhëna nga Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun, Policia e Kosovës, 27 korrik, 2018.

⁴⁷ Intervistë me Zt. Milazim Lumi, Komandant i Policisë në Komunën e Suharekës, 8 tetor 2018.

radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm në këtë komunë.⁴⁸ Duhet theksuar se në kuadër të komunës së Suharekës poashtu funksionojnë edhe dy këshilla që veprojnë në fushën e sigurisë, më saktësisht Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi dhe Këshilli që funksionon si trup koordinativ mes Kryetarit të Komunës dhe Policisë në nivel komunal nga njëra anë dhe përfaqësuesve të KFOR-it dhe OSBE-së, nga ana tjetër. Të dy këto Këshille mbajnë takime të rregullta ku marrin pjesë në mënyrë aktive të gjithë anëtarët e tyre.⁴⁹ Vlen të përmendet se ngjashëm me Komunën e Podujevës, edhe në atë të Suharekës, rol të rëndësishëm në parandalimin e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm ka luajtur edhe vetë popullata në gjithë territorin e komunës meqenëse ajo nuk i ka përkrahur tentativat për aktivitete që çojnë drejt radikalizmit dhe nuk i ka pranuar individët që kanë tentuar të mirren me veprime të tilla. Aktualisht në kuadër të komunës nuk vepron asnjë OJQ që propagon forma më radikale të Islamit. Në të kaluarën ka pasur tentative të tilla, kryesisht të organizatave nga Prizreni, mirëpo përfaqësuesit e këtyre organizatave janë larguar me kërkesë të KBI-së komunale meqenëse kanë vepruar jashta rregullave të BIK-ut.⁵⁰

- **Niveli i kriminalitetit**

Statistikat për nivelin e kriminalitetit në Komunën e Suharekës tregojnë që gjatë vitit të kaluar (2017) në këtë komunë janë kryer gjithsej 603 vepra penale. Pjesa më e madhe e këtyre veprave penale bëjnë pjesë në kategorinë e veprave kundër pasurisë (340) dhe të atyre kundër jetës dhe trupit (158).⁵¹

- **Struktura e popullatës sipas aktivitetit ekonomik**

Të dhënat statistikore (2011) për Komunën e Suharekës tregojnë se nga 42,313 persona të moshës mbi 15 vjet, vetëm 35.48% janë ekonomikisht aktivë, ndërkaq ekonomikisht joaktivë janë deklaruar 64.52% prej tyre. Nga ana tjetër, nga popullsia aktive e moshës mbi 15 vjet, vetëm 53.57% prej tyre janë të punësuar, 3,92% jetojnë me ndihma sociale


⁴⁸ Intervistat me Zt. Bali Muharremaj, Kryetar i Komunës së Suharekës (30 gusht 2018), Imamin 1 në Komunën e Suharekës (30 gusht 2018) dhe me Zt. Milazim Lumi, Komandant i Policisë në Komunën e Suharekës (18 tetor 2018).

⁴⁹ Intervistë me Zt. Milazim Lumi, Komandant i Policisë në Komunën e Suharekës 18 tetor 2018.


⁵⁰ Ibid.

⁵¹ Të dhëna nga Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun, Policia e Kosovës, 7 nëntor 2018.

dhe 5.83% janë të varur nga pensioni si burim kryesor i jetesës.⁵² Struktura e të punësuarve sipas nivelit të arsimit për gjithë popullatën në Komunën e Suharekës, si dhe për grup-moshën 15-29 vjet të popullatës është paraqitur në diagramet e mëposhtme nr. 4 dhe nr. 5.



Diagrami nr.4: Struktura e të punësuarve sipas nivelit të arsimit për gjithë popullatën



Diagrami nr.5: Struktura e të punësuarve sipas nivelit të arsimit për grup-moshën 15-29 vjet

⁵² Popullsia e moshës 15 vjeç e mbi sipas statusit të aktivitetit aktual (2011), Platforma Online ASKDATA, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

Nga ana tjetër, sa i përket qytetarëve që nuk janë ekonomikisht aktivë, 21.40% prej tyre si arsye për këtë e deklarojnë vijimin e shkollimit, 42.76% deklarojnë që kujdesen për familjen apo shtëpinë, ndërsa 2.87 % përmendin arsye të tjera. Edhe me këtë rast, ngjashëm me Komunën e Podujevës, duhet të theksohet se 3.92% e popullatës janë në gjendje ekonomike të rëndë, duke jetuar nga ndihmat sociale, ndërkaq, 5.83% si burim kryesor të jetesës i kanë pensionet.⁵³

- **Buxheti Komunal dhe mbështetja për aktivitetet rinore**

Për nga buxheti total Komuna e Suharekës bën pjesë në komunitet me buxhet mesatar në Kosovë dhe për vitin fiskal 2018 ky buxhet e kap shumën prej 13.78 milion Euro. Duhet theksuar se kjo komunë bën pjesë në tri komunitet të cilat nuk e kanë aprovuar buxhetin në Kuvendet Komunale sipas kufijve buxhetor, megjithatë nga të dhënat në dispozicion mund të konstatohet se të hyrat në buxhet janë kryesisht nga dhënie të qeveritare që përbëjnë rreth 85.96% të totalit të tij, ndërkaq, rreth 14.04% të pjesës së mbetur Komuna i gjeneron nga të hyrat vetanake. Ngjashëm me komunitet tjera, edhe në atë të Suharekës pagat dhe mëditjet mbesin kategoria më e lartë me rreth 58% të buxhetit total. Kategoria e mallrave dhe e shërbimeve bën pjesë me 7.8%, ndërkaq, pjesa që i dedikohet investimeve kapitale është rreth 30% e shumës totale.⁵⁴


Nëse buxhetin e analizojmë në raport me investimet kapitale dhe përkrahjen e kulturës, rinisë dhe sportit, më në veçanti me infrastrukturën dhe aktivitetet që ndërlidhen me rini, shihet që buxheti nuk e përfaqëson në asnjë mënyrë këtë grup të popullatës (grupmosha 15-29 vjet), që e paraqet 28.10% të popullatës së Komunës së Suharekës.

Kështu, në buxhetin për vitin 2018, vetëm 1.98% (273,000 Euro) e buxhetit total parashihet të shpenzohet ashtu që të ketë impakt tek të rinjtë, dhe kjo është e kategorizuar në tërësi në kuadrin e shpenzimeve kapitale dhe subvencioneve, duke paraqitur 6% të këtyre shpenzimeve. Duhet theksuar se pjesa më e madhe e këtyre

⁵³ Ibid.

⁵⁴ Ligji për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018, Ministria e Financave, <https://mf.rks.gov.net/desk/inc/media/668E7D87-490C-4229-881B-E66CE614F4C1.pdf>

fondeve prej 72% është paraparë për shpenzime kapitale, ndërkaj 28% për subvencione dhe transfere.⁵⁵



Ndër tjera, sipas buxhetit parashihet që 44,107 Euro të shpenzohen për subvencione të garave sportive, 25,746 Euro për mbështetjen e shoqërive kulturore-artistike, ndërkaj vetëm 4,950 Euro për ekspozita dhe botime të librave. Nga ana tjetër, në kuadër të investimeve kapitale, 27,000 Euro janë paraparë për rregulimin e ambienteve për aktivitete kulturore dhe festive, 45,000 Euro për ndërtimin dhe renovimin e objekteve sportive dhe kulturore, 108,000 Euro për ndërtimin e Palestrës sportive në Studenqan dhe vetëm 9,500 Euro për ngritjen e kapaciteteve të këshillit të veprimt rinor.⁵⁶

2.3. Analiza Krahasuese e të Dhënave Socio-Ekonomike

Në këtë seksion do të bëhet krahasimi i të dhënave socio-ekonomike në mes të komunave të Podujevës dhe Suharekëse nga njëra anë, dhe komunave të Kaçanikut dhe Hanit të Elezit, në anën tjetër. Është e qartë se duke bërë krahasimin e të dhënave për dy komunat që nuk kanë treguar shenja të radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm me

⁵⁵ Ibid.

⁵⁶ Informata nga Drejtoria për Kulturë, Rini, Sport dhe Mërgatë, Komuna e Suharekës, 15 nëntor 2018.

ato të dy komunave ku niveli i këtyre fenomeneve ka qenë relativisht i lartë, ky seksion ka për qëllim të tregojë vallë ka dallime të konsiderueshme të këtyre karakteristikave midis këtyre dy grupeve të komunave, dhe a thua ekziston një korrelacion midis këtyre karakteristikave dhe shfaqjes së radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm. Për këtë qëllim, më poshtë është dhënë tabela e të dhënave kyçe socio-ekonomike për këto katër komuna.

Në bazë të të dhënave socio-ekonomike nga tabela komparative në mes të katër komunave në fjalë, fillimisht mund të përfundohet se komuna e Podujevës dhe Suharekës janë komuna më të mëdha për nga numri i banorëve krahasuar me komunën e Kaçanikut dhe Hanit të Elezit. Dallimi më i theksuar është në mes të Komunës së Podujevës me popullatë prej 84,223 banorë dhe asaj të Hanit të Elezit me vetëm 10,009 banorë.

Sa i përket strukturës etnike të popullatës mund të konkludohet se shumica absolute e banorëve në këto komuna (96.5%>) janë shqiptarë. Situata është e ngjashme edhe sa i përket strukturës religjioze, meqenëse shumica absolute e banorëve në këto komuna (98%>), janë deklaruar që i përkasin besimit islam. Sa përket numrit të xhamive për 1000 banorë, vërehet se në Komunën e Kaçanikut ky raport është 0.65 xhami në 1000 banorë në fshatra, dhe 0.3 xhami në 1000 banorë në qytet, ndërsa në komunën rurale të Hanit të Elezit ky raport është 1 xhami në 1000 banorë. Nga ana tjetër, në Komunën e Podujevës, raporti i tillë është 0.61 xhami në 1000 banorë në fshatra, dhe 0.134 xhami në 1000 banorë në qytet, ndërsa në komunën e Suharekës ky raport është 0.47 xhami për 1000 banorë në fshatra dhe vetëm 0.096 xhami për 1000 banorë në qytet.

	Podujeva	Suhareka	Kacaniku	Hani i Elezit
Popullata	84223	61181	34409	10009
Qyteti	26.5.%	17.45%	31.10%	*
Fshati	73.5.%	82.55%	68.90%	100%
Grupmosha 0-14	30.30%	29.20%	28.60%	29.50%
Grupmosha 15-29	27.40%	28.10%	27.60%	26.40%
Grupmosha 30+	42.30%	42.70%	43.80%	44.10%
Niveli i Arsimit				
Analfabetë (në 1000 banorë)	48	41	36	39
Pa shkollim fillor (në 1000 banorë)	112	94	85	92
Shkolla fillore (në 1000 banorë)	527	613	523	577
Shkolla e mesme (në 1000 banorë)	304	230	338	290
Studimet e larta (në 1000 banorë)	55	61	53	39
Institucione shkollore fillore dhe të mesme	62	45	27	7
Religjioni				
Xhamitë	41	24	18	10
Klerikë Islam	43	26	21	13
Kisha Katolike	1	1	0	0
Klerikë Katolikë	0	0	0	0
Kisha protestante	0	1	0	0
Klerikë protestantë	2	1	2	2
Kisha ortodokse	1	6	0	0
Luftëtarë të Huaj Terroristë			32	10
Mosha mesatare	*	*	33.6	36.8
Niveli i Arsimit	*	*	Mesëm/Lartë	*
Gjendja ekonomike	*	*	Mesatare/Dobët	Dobët/Mesatare
Prapavija kriminale	*	*	80%	0%
Kriminaliteti (vepra penale/në 1000 banorë)	9.9	10	13.5	6.1
Gjendja ekonomike				
Popullata ekonomikisht aktive	36%	35.50%	35.30%	37.60%
Të punësuar	50.4.%	53.50%	50.50%	46.80%
Me ndihma sociale	3.38%	3.92.%	5%	5%
Të varur nga pensioni	5.92%	5.83.%	5%	6%
Buxheti komunal (EUR)	21.37 milion	13.78 milion	7.7 milion	2.8 milion
Shpenzimet kapitale dhe subvencionet	33%	30.00%	21.45%	36.20%
Shpenzimet kapitale dhe subvencionet për rini	4.00%	6.10%	4.50%	0%

Tanimë është theksuar se ekziston një dallim i madh në mes të komunave të Podujevës dhe Suharekës dhe atyre të Kaçanikut dhe Hanit të Elezit sa i përket numrit të individëve që u janë bashkangjitur luftërave të huaja, domethënë, organizatave terroriste në Irak dhe Siri. Kështu, përderisa në gjithë Komunën e Podujevës ka pasur vetëm një rast të tillë dhe në atë të Suharekës asnjë, në Komunën e Hanit të Elezit janë evidentuar gjithsej 10 individë të tillë apo 1 në 1000 banorë, ndërsa në Komunën e Kaçanikut ky numër arrin në 32 apo në 0.94 individë në 1000 banorë. Mirëpo, nga të dhënat e mësipërme për këto katër komuna, mund të konstatohet se sa i përket strukturës etnike dhe religjioze, nuk ka asnjë dallim në mes të komunave të Podujevës dhe Suharekës me një shkallë tejet të ulët të radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, dhe komunave të Kaçanikut dhe Hanit të Elezit që kanë shkallë jashtëzakonisht të lartë të këtyre dukurive.

Ekziston dallim simbolik sa i përket numrit të xhamive për 1000 banorë në këto katër komuna, meqenëse ky raport është më i larti në komunat rurale të Hanit të Elezit dhe më i vogli në qytetin e komunës së Suharekës. Mirëpo, numri më i madh i xhamive të ndërtuara nuk nënkupton automatikisht edhe rritje të nivelit të radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm në ndonjë komunë. Në këtë drejtim, siç do të analizohet në kapitullin në vijim, shumë më e rëndësishme është se nga cilat organizata është financuar ndërtimi i xhamive të reja, a është bërë ky ndërtim me leje të KBI-së komunale dhe vallë këto organizata e kanë kushtëzuar ndërtimin e xhamive me emërimin e imamëve të caktuar apo kanë insistuar që në këto objekte fetare të predikohen forma radikale të Islamit.

Nga ana tjetër, edhe edhe sa i përket numrit të veprave penale për 1000 banorë nuk vërehen dallime të mëdha dhe rrjedhimisht edhe këto të dhëna nuk paraqesin ndonjë indikator të rëndësishëm që do të mund t'i spjegonte dallimet e mëdha në nivelin e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm në këto katër komuna. Kështu, numri i veprave penale për 1000 banorë është më i larti në Komunën e Kaçanikut (13.5) dhe më i ulëti në Komunën e Hanit të Elezit (6.1), edhe pse numri i individëve në 1000 banorë që u janë bashkangjitur luftërave të huaja është përafërsisht i njëjtë në të dy komunat. Në komunat e Podujevës dhe Suharekës ky numër është 9.9 respektivisht 10 vepra penale për 1000 banorë, dmth. më i madh se në Komunën e Hanit të Elezit e cila ka një shkallë mjaft të lartë të radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm. Madje, është interesant të përmendet se përderisa nga 32 individë në Komunën e Kaçanikut që u janë

bashkangjitur luftërave të huaja, madje 80% kanë të kaluar kriminale, në Komunën e Hanit të Elezit kjo përqindje është 0%.

Ndër faktorët socio-ekonomikë që në shumë studime janë theksuar si tejet të rëndësishëm për shfaqjen e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm padyshim bëjnë pjesë gjendja ekonomike dhe niveli i arsimit. Sa i përket nivelit të arsimit, mund të përfundohet se katër komunat që diskutohen, kanë nivel relativisht të përafërt në këtë drejtim. Kështu, nga aspekti i numrit të atyre që kanë të përfunduar studimet universitare dhe pas-universitare në 1000 banorë, nivelin më të lartë të arsimit e ka Komuna e Suharekës, ndërsa më të ulët ajo e Hanit të Elezit. Mirëpo, nga aspekti i numrit të atyre që kanë të përfunduar shkollën e mesme në 1000 banorë, nivelin më të lartë të arsimit e ka Komuna e Kaçanikut, ndërsa më të ulët ajo e Suharekës. Sa i përket gjendjes ekonomike të banorëve në këto katër komuna, duhet theksuar se në Komunën e Kaçanikut 5.00% e popullatës jetojnë nga ndihmat sociale, dhe 5.00% nga pensionet, ndërkaq në Komunën e Hanit të Elezit 5.00% e popullatës jetojnë nga ndihmat sociale, dhe 6.00% nga pensionet. Në komunën e Suharekës dhe Podujevës, situata është paksa më e mirë sepse vetëm 3.38% respektivisht 3.92% e popullatës jetojnë nga ndihmat sociale, ndërsa 5.92% respektivisht 5.83% nga pensionet. Sidoqoftë, këto dallime lidhur me nivelin e arsimit dhe gjendjen ekonomike mes katër komunave janë të vogëla, dhe rrjedhimisht të parëndësishme për të spjeguar dallimet tejet të mëdha në nivelin e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm mes këtyre komunave.

Natyrisht, gjatë analizës së të dhënave socio-ekonomike për katër komunat në fjalë, vëmendje e posaçme duhet t'i kushtohet grup-moshës 15-29 vjet, meqenëse kjo grup-moshë padyshim është më vulnerabilja ndaj radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm. Në këtë drejtim, në rend të parë mund të përfundohet se përqindja e kësaj grup-moshe në numrin e tërësishëm të banorëve është përafërsisht e njëjtë në të gjitha komunat, edhe pse më e larta është në Komunën e Suharekës (28.10%) dhe më e ulëta në atë të Hanit të Elezit (26.40%). Poashtu mund të konstatohet se shumica absolute e popullatës së grup-moshës 15-29 vjet jetojnë në pjesët rurale të këtyre katër komunave. Sa i përket objekteve të arsimit fillor dhe të mesëm nga aspekti i numrit të shkollave për 1000 banorë të moshës deri në 19 vjet, në Komunën e Kaçanikut ky raport është 2.08, në atë të Hanit të Elezit 1.9, në Podujevë 1.75 dhe në Suharekë 1.88. Vërehet se dallimet në këtë drejtim janë relativisht të vogëla, madje komuna e Kaçanikut dhe ajo e Hanit të

Elezit kanë numër më të madh të shkollave për 1000 banorë në krahasim me komunën e Podujevës dhe atë të Suharekës, edhe pse numri i individëve që u është bashkangjitur luftërave të huaja dhe niveli i radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm është shumë më i lartë. Rrjedhimisht, mund të përfundojmë se të dhënat për grup-moshën 15-29 vjet në katër komunat e shqyrtuara janë mjaft të ngjashme dhe si të tilla nuk mund t'i shpjegojnë dallimet tejet të mëdha në nivelin e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm mes këtyre komunave.

Nga aspekti i përqindjes së të punësuarve varësisht nga niveli i arsimit, mund të konstatohet se situata për këtë grup-moshë është mjaft e ngjashme në të katër komunat. Kështu në Komunën e Podujevës, 64.5% të të punësuarve të moshës 15-29 vjet janë me shkollë të mesme, 16.8% me studime të përfunduara universitare dhe 1.2% me ato pas-universitare. Në Komunën e Suharekës, përqindjet e të punësuarve të të rinjve me studime të përfunduara universitare dhe pas-universitare janë identike me ato të Podujevës, ndërkaq përqindja e të punësuarve me shkollë të mesme është më e vogël dhe arrin 54.4%. Në komunën e Kaçanikut dhe të Hanit të Elezit këto përqindje janë përafërisht të njëjta dhe nuk dallojnë shumë nga dy komunat tjera.

Një nga problemet në të katër komunat ka të bëjë me infrastrukturën kulturore dhe sportive për të rinjtë, meqenëse ajo është tejet e varfër dhe nuk i plotëson as për së afërmi nevojat e kësaj grup-moshe të popullatës. Duhet theksuar se në të gjitha komunat funksionojnë klube dhe shkolla sportive, ndërkaq që rinia ka në dispozicion një numër të fushave të futbollit, të palestrave dhe komplekseve sportive. Poashtu funksionon edhe një numër i caktuar i bibliotekave, qendrave rinore dhe qendrave të kulturës. Megjithatë, në të katër komunat infrastruktura ekzistuese kulturore dhe sportive as për së afërmi nuk i plotëson nevojat për aktivitetet jashtëshkollore për të rinjtë e këtyre komunave. Një gjë e tillë mund të vërehet edhe nga shpenzimet kapitale dhe subvencionet për kulturë, sport dhe rini të parapara sipas buxheteve në këto katër komuna. Kështu në Komunën e Podujevës këto shpenzime paraqesin 4.00% të vlerës së përgjithshme të shpenzimeve kapitale, në atë të Suharekës 6.10%, në atë të Kaçanikut 4.50%, ndërkaq në Komunën e Hanit të Elezit shpenzime të tilla nuk janë paraparë fare, dmth. 0.00%. Pra mund të konstatohet se në përgjithësi rinia e grup-moshave 15-29 vjet në këto komuna ka në disponim një infrastrukturë tejet të varfër, madje shpesh edhe joekzistuese komunale në fushën e sportit, kulturës dhe të aktiviteteve të tjera ekstra-

kurrikulare. Këto të dhëna sugjerojnë se rinia në të katër komunat jeton për afërsisht në kushte të ngjashme sa i përket infrastrukturës kulturore dhe sportive që ata kanë në dispozicion për aktivitetet e tyre. Rrjedhimisht, mund të përfundohet se edhe këta indikatorë socio-ekonomikë nuk mund t'i shpjegojnë dallimet e mëdha në mes të komunave të Podujevës dhe Suharekës dhe atyre të Kaçanikut dhe Hanit të Elezit sa i përket numrit të individëve që u janë bashkangjitur luftërave të huaja, si dhe shkallës së përgjithshme të radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm.

3. Analizë: Pse nuk ka Ekstremizëm të Dhunshëm në Komunitet e Podujevës dhe Suharekës?

Siç u tregua më lartë, analiza krahasuese e të dhënave socio-ekonomike e bërë për katër komunitet nuk ka treguar ndonjë dallim signifikan në mes të Podujevës dhe Suharekës me nivel të ulët të radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm dhe komunitet të Kaçanikut dhe Hanit të Elezit, ku janë vërejtur nivelet më të larta të këtyre dukurive në gjithë Kosovën. Për deri sa kjo analizë sërish e ka sfiduar qartë paradigmen socio-ekonomike të shfaqjes së mostolerancës fetare dhe ekstremizmit të dhunshëm, ajo nuk kanë dhënë përgjigje në pyetjen përse në komunitet e Podujevës dhe Suharekës niveli i radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm është shumë më i ulët se në disa komunitet të tjera? Për t’ju përgjigjur kësaj pyetje janë realizuar një varg intervistash në të dy komunitet. Me këtë rast janë intervistuar kryetarët e komunitet, përfaqësuesit e partive kryesore politike, përfaqësuesit e Këshillave të Bashkësisë Islame, imamë të angazhuar në të dy komunitet, si dhe përfaqësues të policisë, shoqërisë civile dhe mediave.

Me qëllim të gjetjes së përgjigjes për nivelin tejet të ulët të radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm në këto dy komunitet, gjatë intervistave u është kushtuar vëmendje një varg çështjeve të cilat ndërlidhen me këtë temë. Kështu, një çështje e rëndësishme që është hulumtuar kanë qenë raportet fetare mes shqiptarëve në këto komunitet, dhe atë gjatë periudhës (1989–1999) që përkon me rezistencën paqësore dhe të armatosur të shqiptarëve të Kosovës dhe që karakterizohet me një shkallë të lartë të homogjenizimit shoqëror. Poashtu është analizuar edhe periudha gjatë viteve (1999–2008), pra periudha e administrimit ndërkombëtar kur në esencë fillon fragmentimi shoqëror dhe rritja e fetarizimit i të gjithë shoqërisë në Kosovë. Së fundit, kujdes i veçantë i është kushtuar edhe periudhës pas shpalljes së pavarësisë, dmth. pas vitit 2008, kur edhe vërehet rritja e radikalizmit fetar dhe fillon shfaqja e ekstremizmit të dhunshëm.

Gjithsesi, një rëndësi të veçantë në zbërthimin e kësaj çështje e kanë faktorët që kanë ndikuar në shfaqjen e agjendave publike me karakter fetar dhe të radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm në Kosovë. Rrjedhimisht, është analizuar me kujdes edhe

roli i bashkësive fetare si në nivel të gjithë vendit, ashtu edhe në kuadër të komunave në fjalë, në lidhje me identitetin shqiptar, por edhe një varg elementesh që ndërlidhen me veprimtarinë e drejtpërdrejtë të BIK-ut me besimtarët e fesë islame. Kështu, gjatë hulumtimit është tentuar të kuptohet se çfarë formash të interpretimit të Islamit predikohen në këto dy komuna, vallë kontrollohet predikimi i imamëve, si dhe në cilat vende janë shkolluar imamët që predikojnë në këto komuna. Në këtë drejtim, vëmendje e posaçme i është kushtuar numrit të xhamive që janë ri-ndërtuar dhe ndërtuar pas lufte në të dy komunat, dhe se sa prej tyre eventualisht janë ndërtuar prej shoqatave nga Lindja e Mesme me karakter Vahabist, Salafist dhe të Vëllazërisë Muslimane. Në rastet kur ka pasur xhami të ndërtuara nga shoqatat e tilla, ka qenë me rëndësi të kuptohet se vallë këto shoqata kanë insistuar që në këto xhami të shërbejnë imamë të caktuar dhe a është imponuar nga këto shoqata predikimi i Islamit radikal. Në pjesën përfundimtare të hulumtimit, rëndësi e posaçme i është kushtuar bashkëpunimit në mes të Këshillave të Bashkësisë Islame me pushtetin lokal dhe policinë, por edhe me mediat lokale dhe shoqërinë civile. Njëkohësisht është analizuar edhe roli i partive të ndryshme politike që janë aktive në këto komuna në parandalimin e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm.

3.1. Analizë: Komuna e Podujevës

Banorët e Komunës së Podujevës dhe të regjionit të Llapit në përgjithësi, tradicionalisht kanë qenë më fetarë se qytetarët në pjesët tjera të Kosovës. Fakti se popullata në këto treva ishte kryesisht homogjene, si në aspektin etnik ashtu edhe në atë fetar, mundësoi që për shumë kohë në të kaluarën marrëdhëniet fetare të jenë në nivel të kënaqshëm. Sidomos gjatë periudhës 1989-1999, pra gjatë periudhës së rezistencës paqësore dhe të armatosur të Shqiptarëve ndaj regjimit diskriminues të Millosheviqit, homogjenizimi i popullatës në këtë komunë ishte në shkallën më të lartë. Të gjithë të intervistuarit pajtohen se gjatë kësaj periudhe të gjithë banorët e komunës kanë qenë thellësisht të angazhuar për kauzën kombëtare, duke i lënë plotësisht anash çështjet fetare. Madje

edhe të gjithë imamët që vepronin në kuadër të komunës, gjatë kësaj periudhe janë vënë në shërbim të aktiviteteve dhe përpjekjeve për liri dhe çlirim kombëtar.⁵⁷

Pas konfliktit të vitit 1999, gradualisht fillon ndryshimi i situatës në gjithë Kosovën, por edhe në Komunën e Podujevës. Në rend të parë fillon ri-fetarizimi i popullatës dhe rritet në masë të madhe numri i praktikuesve të fesë. Njëkohësisht rritet dukshëm interesimi i të rinjve për të njohur dhe mësuar fenë islame.⁵⁸ Nga ana tjetër, menjëherë pas luftës në Kosovë arritën edhe organizata të ndryshme, kryesisht nga shtetet e Gjirit, të cilat padyshim kishin agjenda fetare të kamufluara nën petkun humanitar. Në këtë mënyrë, qytetarët e Kosovës për herë të parë u ballafaquan me forma radikale të predikimit të Islamit që deri atëherë kishin qenë të panjohura për ta.⁵⁹ Përfaqësues të lëvizjeve Vahabiste, Salafiste apo të Vëllazërisë Muslimane, përveç ndarjes së ndihmave për popullatën e dërmuar nga lufta të Kosovës, filluan edhe predikimin e formave të tyre të Islamit që ishin në kundërshtim me islamin tradicional të praktikuar në Kosovë me shekuj.⁶⁰ Shoqatat e këtilla u angazhuan edhe në renovimin e xhamive të dëmtuara nga lufta, por edhe në ndërtimin e një varg xhamive të reja. Shpesh herë këto aktivitete kushtëzoheshin me predikimin e formave të tyre të Islamit nëpër xhamitë e renovuara apo të ndërtuara.⁶¹ Në të njëjtën kohë, këto shoqata filluan rekrutimin e imamëve të cilët do të studionin në vendet arabe të Gjirit, dhe të cilë pas kthimit nga studimet do të predikonin format radikale të Islamit karakteristike për vendet ku kishin përfunduar studimet.⁶² Të gjitha këto aktivitete ndodhnin para syve të administratës ndërkombëtare të UNMIK-ut, e cila jo vetëm që nuk ndërmerri asnjë hap konkret në pengimin e aktiviteteve të organizatave të tilla, por ndonjëherë me gjasë edhe e favorizonte një aktivitet të tillë.⁶³ Tendencat e këtilla negative të këtyre organizatave janë vërejtur me kohë nga KBI i Komunës së Podujevës dhe në bashkëpunim me një pjesë të imamëve lokalë menjëherë ka filluar mobilizimi për parandalimin e dukurive të tilla, si dhe për ruajtjen dhe kultivimin e vlerave fetare tradicionale të shqiptarëve në këto treva të cilat

⁵⁷ Qëndrimet e këtilla janë konfirmuar unanimisht gjatë tetë intervistave të zhvilluara me përfaqësues të komunës, partive politike, KBI-së, policisë, mediave dhe shoqërisë civile.

⁵⁸ Intervistë me Imamin 3 të Komunës së Podujevës, 30 gusht 2018.

⁵⁹ Intervistë me Zt. Rafet Llapashtica, kryetar i degës së PDK-së në Podujevë, 14 shtator 2018.

⁶⁰ Intervistë me Imamin 1 të Komunës së Podujevës, 09 gusht 2018.

⁶¹ Intervistë me Imamin 3 të Komunës së Podujevës, 30 gusht 2018.

⁶² Intervistë me Imamin 1 të Komunës së Podujevës, 09 gusht 2018.

⁶³ Intervistë me Imamin 3 të Komunës së Podujevës, 30 gusht 2018.

gjithmonë kanë qenë të mishëruara me çështjen kombëtare shqiptare. Megjithatë, gjatë kësaj periudhe në territorin e komunës u shfaq haptas polarizimi në praktikim dhe interpretim të fesë islame, si në disa prej xhamive, ashtu edhe në mesin e xhematit, që si pasojë kishte fragmentimin shoqëror të shqiptarëve në emër të fesë.⁶⁴

Pas shpalljes së pavarësisë në vitin 2008, edhe pse shumica e organizatave të këtilla ishin mbyllur apo përzënë nga Kosova, pasojat ishin evidente sepse tanimë kishte filluar shfaqja e grupeve radikale në vetë shoqërinë shqiptare në Kosovë. Në këtë periudhë filloi cënimi i simboleve kombëtare të shqiptarëve dhe përdhosja e figurave të ndritura të historisë kombëtare shqiptare si dhe ofendimi publik i tyre për shkak të agjendave të caktuara fetare.⁶⁵ Edhe në komunën e Podujevës, përkundër angazhimit permanent të KBI-së, filloi krijimi i celulave të para të një praktikimi dhe interpretimi radikal të fesë islame. Kjo prurje e re në Komunën e Podujevës ishte si rezultat i angazhimit të madh të disa imamëve të BIK-ut qendror nga Prishtina të cilët vazhdimisht zhvillonin aktivitete për të thelluar rrënjët e ideologjisë vehabiste e cila është bazament i radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm.⁶⁶ Gjatë kësaj periudhe ka pasur tendenca të disa grupeve të vogëla edhe për t'u futur me dhunë nëpër xhami për t'i marrë nën kontroll. Poashtu ka pasur raste kur individët e tillë kanë tentuar ta prishin atmosferën gjatë namazeve duke shpërndarë idetë e tyre radikale dhe format jotradicionale të faljes.⁶⁷

Nga një numër faktorësh të shumtë që kanë ndikuar në shfaqjen e agjendave publike me karakter fetar të radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm në Kosovë, faktori qenësor ka të bëjë me veprimtarinë e disa imamëve nga Kosova. Këta individë, për interesa personale materiale i përqaftuan këto forma radikale të interpretimit dhe praktikimit të fesë islame me gjenezë nga shtetet e Gjirit Persik.⁶⁸ Për fat të keq, këta imamë një kohë të gjatë vepruan lirshëm në mbarë Kosovën, pa u penguar as nga insitucionet shtetërore as nga ato fetare. Realisht, ata vepruan me bekimin e kreut të BIK-ut i cili në një farë mënyre rezultoi se është në koalicion me këta imamë me qëllim

⁶⁴ Ibid.

⁶⁵ Intervistë me Imamin 1 të Komunës së Podujevës, 09 gusht 2018.

⁶⁶ Intervistë me Imamin 3 të Komunës së Podujevës, 30 gusht 2018.

⁶⁷ Intervistë me Zt. Agim Veliu, Kryetar i Komunës së Podujevës, 09 gusht 2018.

⁶⁸ Intervistë me Imamin 2 të Komunës së Podujevës, 09 gusht 2018.

të zhvatjesh të fondeve nga këto vende.⁶⁹ Fatkeqësisht, alarmi për fenomenet e këtilla në mbarë vendin u ngrit vetëm atëherë kur të rinjtë shqiptarë nga Kosova filluan të shkojnë në Siri dhe Irak, për t'ju bashkangjitur luftëtarëve të ISIS-it dhe grupeve të tjera që luftonin atje. Deri në atë moment, me keqardhje mund të konstatohet se të gjitha institucionet shtetërore dhe fetare në nivelin qendror që do të duheshin t'i parandalonin fenomenet e tilla në mbarë vendin ishin zënë pak a shumë në gjumë.⁷⁰

Të gjithë të intervistuarit në kuadër të komunës janë unanimesë se një nga arsyet kryesore pse radikalizmi dhe ekstremizmi i dhunshëm nuk kanë arritur të depërtojnë në masë më të madhe në Komunën e Podujevës ndërlidhet me punën e palodhshme të KBI-së dhe një numri të imamëve lokalë. Në rend të parë, përfaqësuesit e KBI-së që nga fillimi e kanë rezistuar infiltrimin e shoqatave apo individëve që predikonin format radikale të Islamit. Vazhdimisht është biseduar me popullatën, dhe atë jo vetëm në xhami gjatë namazit, por edhe gjatë tubimeve, nëpër shkolla dhe në medime. Janë demaskuar ideologjitë e këtilla radikale si të huaja dhe të dëmshme për shqiptarët në Kosovë.⁷¹ Poashtu, KBI është treguar vigjilent edhe gjatë procesit të rindërtimit të xhamive të shkatërruara gjatë luftës apo ndërtimit të xhamive të reja. Në Komunën e Podujevës para luftës kishte gjithsej 23 xhami, ndërkaq sot numri i tërësishëm i tyre është 41 dhe të gjitha janë funksionale. Duhet theksuar se KBI në kontinuitet i ka refuzuar ndihmat financiare nga organizatat e huaja të cilat këtë proces të (ri)ndërtimit e kanë kushtëzuar me emërimin e imamëve të caktuar në këto xhami apo kanë insistuar që në këto objekte fetare të predikohen forma radikale të Islamit. Përkundër ofertave të shumta nga organizatat e huaja për ndërtimin e xhamive të reja me kushte të këtilla të imponuara, kryesia e KBI-së vazhdimisht i ka refuzuar ato. Rrjedhimisht, nga 18 xhami të reja që janë ndërtuar pas luftës në Komunën e Podujevës, vetëm një është ndërtuar nga organizata Kosova Aid and Development (KAD) nga Kuvajti dhe asnjë nuk është finansuar prej organizatave të Arabisë Saudite.⁷² Në gjithë Komunën, ka qenë vetëm një xhami, ndërtimi i së cilës ka filluar në mënyrë jo të rregullt, nga një person që është banor i komunës, por me detyrë është imam në Prishtinë dhe ka orientim vehabist. Kjo xhami është ndërtuar pa menaxhimin dhe mbikqyrjen e KBI-së pikërisht për shkak të

⁶⁹ Intervistë me Imamin 3 të Komunës së Podujevës, 30 gusht 2018.

⁷⁰ Intervistë me Imamin 1 të Komunës së Podujevës, 09 gusht 2018.

⁷¹ Intervistë me Imamin 2 të Komunës së Podujevës, 09 gusht 2018.

⁷² Intervistë me Imamin 1 të Komunës së Podujevës, 09 gusht 2018.

mospërfilljes së kriterëve të përcaktuara me rregulloret e KBI-së dhe BIK-ut për ndërtimin e xhamive. Më vonë, kjo xhami megjithatë është futur nën menaxhimin e KBI-së dhe aty sot është i angazhuar një imam i caktuar nga Kryesia e KBI-së në Podujevë dhe ajo funksionon në kuadër të këtij Këshilli.⁷³

Duhet theksuar se KBI në Podujevë me kohë e ka hartuar dhe miratuar një platformë për parandalimin dhe luftimin e predikimit të formave radikale të Islamit. Rrjedhimisht, imamëve që kanë vepruar në kuadër të KBI-së në Podujevë nuk u është lejuar të dalin jashtë kësaj platforme, dmth. asnjëri nga imamët në Podujevë nuk ka dalur publikisht në mbështetje të këtyre lëvizjeve ideologjike, siç ka pasur raste nga imamë në Prishtinë dhe komunat tjera.⁷⁴ Fatkeqësisht, një veprim i këtillë nuk ishte ndërmarrë asnjëherë nga kryesia e BIK-ut në Prishtinë, e cila kishte mbetur indiferente ndaj këtyre fenomeneve negative. Rrjedhimisht, BIK-u qendror në këtë apo në atë mënyrë mund të konsiderohet se është ndër fajtorët kryesorë për këtë gjendje të krijuar.⁷⁵

Kryesia e KBI në Podujevë ka treguar vendosmëri dhe mençuri edhe gjatë procesit të emërimit të imamëve në xhamitë e ndryshme në nivel të komunës. Gjatë këtyre emërimeve, KBI ka refuzuar që në kuadër të institucionit të pranojë cilindo imam apo nëpunës për të cilët janë siguruar prova se kanë qenë të involvuar në predikimin e formave radikale të Islamit apo kanë qenë përkrahës të këtyre lëvizjeve. Shpesh kjo politikë e emërimit të imamëve është kontestuar dhe kundërshtuar nga Kryesia Qendrore e BIK-ut dhe madje ka shkaktuar edhe tensione serioze në drejtimin KBI – BIK.⁷⁶ Përveç kujdesit të veçantë gjatë emërimit, kryesia e KBI-së, poashtu rregullisht i ka kontrolluar predikimet e imamëve që kanë vepruar në kuadër të komunës për t'u siguruar se ato predikime nuk janë në kundërshtim me Islamin tradicional të praktikuar në Kosovë dhe të preferuar nga KBI. Njëherit, kryesia e KBI-së dhe imamët e angazhuar në kuadër të Këshillit kanë refuzuar çfarëdo lloj bashkëpunimi me shoqata apo individë që kanë përhapur forma radikale të predikimit të Islamit.⁷⁷

⁷³ Intervistë me Imamin 3 të Komunës së Podujevës, 30 gusht 2018.

⁷⁴ Intervistë me Imamin 2 të Komunës së Podujevës, 09 gusht 2018.

⁷⁵ Intervistë me Imamin 3 të Komunës së Podujevës, 30 gusht 2018.

⁷⁶ Intervistë me Imamin 1 të Komunës së Podujevës (09 gusht 2018) dhe intervistë me Imamin 3 të Komunës së Podujevës (30 gusht 2018).

⁷⁷ Ibid.

Duhet theksuar se Kryesia e KBI-së në Podujevë ka qenë e vëmendshme edhe në parandalimin e instalimit të shoqatave nga Lindja e Mesme me karakter Vehabist dhe Salafist. Rrjedhimisht, në këtë komunë, edhe përkundër përpjekjeve sidomos gjatë fazës së hershme të pasluftës, shoqatat e këtilla nuk kanë arritur të gjejnë bashkëpunëtorë të brendshëm siç ka ndodhur në trevat tjera në Kosovë, ku edhe kanë vepruar për një kohë të gjatë pa u penguar nga askush.⁷⁸ Një periudhë ka qenë aktive dega e shoqatës “Asociacioni për Kulturë, Edukim dhe Arsim” (AKEA), e cila nga aspekti i predikimit ka qenë e afërt me Vëllazërinë Myslimane, ndërkaq që ka vepruar edhe një shoqatë lokale – “Devotshmëria” e cila i ka propaguar format radikale të Islamit. Mirëpo, KBI asnjëherë nuk ka bashkëpunuar me organizatat e këtilla, nuk ka realizuar as edhe një aktivitet të përbashkët dhe thjesht i ka injoruar ato.⁷⁹ Pra, edhe pse disa nga këto shoqata kanë vepruar edhe në kuadër të Komunës së Podujevës duke shpërndarë ndihma, duke organizuar kurse të ndryshme me të rinjtë si dhe ekskurziona dhe kampingje, ndikimi i tyre ideologjik ka qenë simbolik. Në esencë, KBI në Podujevë që nga fillimi kishte marrë vendim të prerë për mosbashkëpunim me shoqata apo individë të tillë. Me kohë janë konstatuar dhe analizuar pasojat e një veprimtarie të tillë dhe përmes një platforme të miratuar janë përcaktuar angazhimet konkrete të të gjithë pjesëtarëve të KBI-së dhe imamëve lokalë për ruajtjen e vlerave tradicionale fetare dhe kombëtare karakteristike për këtë trevë.⁸⁰

Në këtë drejtim, në nivel të lartë ka qenë edhe bashkëpunimi me autoritetet komunale të cilat kanë refuzuar të japin leje ndërtimi për objektet e reja fetare në rast se paraprakisht nuk është marrë pëlqimi nga KBI-ja. Poashtu, kontaktet mes pushtetit lokal dhe KBI-së kanë qenë të vazhdueshme me qëllim të luftimit të formave radikale të predikimit të Islamit. Imamët e KBI-së janë ftuar nga ana e pushtetit lokal në aktivitete të ndryshme nëpër shkolla, por edhe në familje për të sqaruar elementet kryesore të Islamit tradicional.⁸¹ Bashkëpunimi ka qenë i kënaqshëm edhe me Policinë e Kosovës, e cila ka intervenuar në parandalimin e aktiviteteve të grupeve radikale çdo herë që këtë e ka kërkuar KBI ose autoritetet komunale. Madje, ekzistojnë mendime se policia ka luajtur rol kyç sepse pas disa aksioneve të ndërmarra dhe burgosjes së disa individëve

⁷⁸ Intervistë me Imamin 3 të Komunës së Podujevës, 30 gusht 2018.

⁷⁹ Intervistë me Imamin 1 të Komunës së Podujevës, 09 gusht 2018.

⁸⁰ Intervistë me Imamin 3 të Komunës së Podujevës, 30 gusht 2018.

⁸¹ Intervistë me Zt. Agim Veliu, Kryetar i Komunës së Podujevës, 09 gusht 2018.

me veprimtari radikale, të tjerët janë dekurajuar dhe dalëngadalë janë larguar nga territori i komunës.⁸² Duhet theksuar se bashkëpunimi i këtillë ka qenë i vazhdueshëm dhe ndër tjera është shprehur edhe në kuadër të takimeve të rregullta të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi ku shpesh janë diskutuar edhe tema që ndërlidhen me këto çështje. Në të vërtetë, mund të konstatohet se një nga kushtet e rëndësishme për parandalimin e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm është bashkëpunimi i suksesshëm mes autoriteteve lokale fetare, pushtetit lokal dhe policisë. Poashtu, është konstatim i përbashkët i të gjithë të intervistuarve se në përgjithësi veprimtaria e shoqatave të tilla, përveç se është luftuar nga KBI, pushtetit lokal dhe policia, poashtu nuk është pranuar edhe nga popullata lokale.

Sa i përket rolit të partive politike në parandalimin e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm në Komunën e Podujevës, mendimet e të intervistuarve janë të ndara. Përfaqësuesit e pushtetit lokal dhe partive politike janë të mendimit se partitë politike kanë luajtur rol të rëndësishëm dhe pozitiv në këtë drejtim.⁸³ Mirëpo, të intervistuarit nga rradhët e KBI-së, medimeve dhe shoqërisë civile janë të mendimit se përveç disa përjashtimeve të vogëla, partitë politike gati aspak nuk kanë vepruar në parandalimin e këtyre dukurive negative. Aktivitetet e tyre kryesisht kanë qenë drejt sigurimit të përkrahjes dhe votave gjatë fushatave zgjedhore. Madje, disa nga të intervistuarit pretendojnë se gjatë fushatave zgjedhore, figura të njohura të politikës kanë koketuar dhe bashkëpunuar me individë të caktuar që kanë qenë protagonistët kryesorë të përhapjes së vehabizmit, vetëm për të siguruar disa vota për vete dhe subjektin e tyre.⁸⁴

Në përgjithësi, bashkëpunimi lidhur me këtë fenomen ka qenë në nivel të kënaqshëm edhe në relacionin mes KBI-së dhe shoqërisë civile dhe mediave lokale. Shpesh, anëtarë të kryesisë së KBI-së apo imamë nga komuna janë paraqitur në mediumet lokale për të sqaruar dëmet e predikimeve radikale të Islamit që tentonin të infiltrohen në territorin e komunës. Përmes debateve dhe ligjëratave këta përfaqësues fetarë kanë sqaruar dhe

⁸² Intervistë me Zt. Bekim Bislimi, Komandant i Policisë në Komunën e Podujevës (19 tetor 2018) dhe me Zt. Patriot Rudari, Kryetar i degës së AAK-së në Podujevë (14 shtator 2018).

⁸³ Intervistat me Zt. Agim Veliu, Kryetar i Komunës së Podujevës (09 gusht 2018), Zt. Patriot Rudari, Kryetar i degës së AAK-së në Podujevë (14 shtator 2018) dhe Zt. Rafet Llapashtica, Kryetar i degës së PDK-së në Podujevë (14 shtator 2018).

⁸⁴ Intervistë me Imamin 1 të Komunës së Podujevës (09 gusht 2018) dhe Imamin 2 të Komunës së Podujevës (09 gusht 2018).

shpërndarë njohuri të sakta për Islamin dhe gjithashtu e kanë shpjeguar të vërtetën lidhur me lëvizjet e reja me karakter radikal.⁸⁵ Njëkohësisht KBI dhe imamët e angazhuar në kuadër të këtij Këshilli kanë marrë pjesë në ngjarje të ndryshme dedikuara rinisë të organizuara nga përfaqësuesit e shoqërisë civile. Me ftesë të organizatave të shoqërisë civile janë mbajtur ligjërata për nxënësit e shkollave të mesme me qëllim të njohtimit të tyre për vlerat tradicionale të fesë Islame. Sipas përfaqësuesve të shoqërisë civile në këtë komunë, KBI dhe imamët kanë qenë tejet bashkëpunues dhe gjithmonë, pa kurrëfarë kompenzimi financiar, janë kyçur në trajnime, debate dhe aktivitetet të tjera të organizuara nga shoqëria civile. Për më tepër, përfaqësuesit e shoqërisë civile janë të bindur se angazhimi i drejtë dhe korrekt i KBI-së dhe imamëve lokalë ka pasur ndikim të madh pozitiv tek të rinjtë në komunë dhe ka kontribuar drejtpërdrejtë në parandalimin e depërtimit të ideologjive radikale të Islamit që shpiejnë në radikalizëm dhe ekstremizëm të dhunshëm.⁸⁶ Në përgjithësi, ka qenë një luftë e përbashkët në të gjitha frontet kundër çdo përpjekje të kujtqo qoftë për rrënimin e vlerave tradicionale dhe futjen e ideologjive të huaja që çojnë në akte të dhunshme.

Mirëpo, ka zëra që thonë se kohëve të fundit situata në Komunën e Podujevës ka filluar të përkeqësohet sa i përket radikalizmit dhe ekstremizmit fetar. Ky realitet kryesisht ndërlihet me ndryshimet që janë bërë në KBI në kuadër të komunës, si dhe ndryshimeve në Rregulloren e BIK-ut lidhur me emërimin e imamëve në të gjitha komunat në Kosovë. Nga njëra anë, ndryshimet në KBI kanë sjellur deri te një tolerancë më e madhe ndaj imamëve dhe individëve të tjerë të cilët predikojnë forma radikale të Islamit. Një gjë e tillë paraqet rrezik, sepse mosluftimi i rasteve të tilla mund të çojë deri te rritja e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm në këtë komunë. Nga ana tjetër, deri te ndryshimet e fundit të Rregullores, imamët në kuadër të komunës janë emëruar me propozim të drejtpërdrejtë nga kryesia e KBI dhe vetëm janë aprovuar nga BIK-u. Me ndryshimet e fundit, të gjitha ingerencat për emërimin e imamëve nëpër komuna kanë kaluar në duart e BIK-ut.⁸⁷ Në këtë mënyrë, marrë parasysh se në kryesinë e BIK-ut tanimë ka individë me pikëpamje radikale, ekziston rreziku që në Komunën e Podujevës, por edhe gjetiu në Kosovë, të emërohen imamë të cilët predikojnë forma

⁸⁵ Intervistë me Zt. Enver Hyseni, përfaqësues i Radio Llapit në Komunën e Podujevës, 14 shtator 2018.

⁸⁶ Intervistë me Znj. Donjetë Shaqiri, drejtoreshë e rrjetit të OJQ-ve në Komunën e Podujevës, 15 shtator 2018.

⁸⁷ Intervistë Imamin 1 të Komunës së Podujevës, 09 gusht 2018.

radikale të Islamit, të ndryshme nga format tradicionale të predikuara në Kosovë me shekuj.

Tanimë në Komunën e Podujevës për imam në një xhami të caktuar është emëruar një individ i cili më herët ka qenë drejtor i degës në Podujevë të organizatës joqeveritare tanimë të përmendur AKEA.⁸⁸ Kësaj organizate, bashkë me 13 të tjera, në vitin 2015 Ministria e Administratës Publike i kishte lëshuar vendim për pezullim të punës për shkak të dyshimit se është e ndërlidhur apo e financuar nga organizata të dyshimta e që lidhen me terrorizmin dhe promovimin e Islamit radikal.⁸⁹ Në rast se edhe më tutje vazhdon praktika e emërimit të imamëve që predikojnë forma radikale të Islamit, mund të ndodhë që në Komunën e Podujevës të rritet niveli i radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, dhe në këtë mënyrë të rrezikohet puna e mirë që është bërë në këtë komunë nga ana e KBI-së dhe imamëve lokalë për gati 20 vjet.

3.2. Analizë: Komuna e Suharekës

Për dallim nga Komuna e Podujevës, qytetarët e rajonit të Suharekës tradicionalisht asnjëherë nuk ka qenë tepër fetarë. Me këtë zbehet edhe spjegimi nga disa qarqe se arsyeja pse radikalizmi dhe ekstremizmi i dhunshëm nuk ka arritur të lëshojë rrënjë në rajonin e Llapit ka të bëjë me faktin se popullata në atë pjesë të Kosovës ka qenë gjithmonë më fetare se qytetarët në pjesët tjera të vendit. Marrë këtë parasysh, gjithsesi arsyet për mos shfaqjen e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm në Komunën e Suharekës duhet kërkuar tek faktorë të tjerë. Poashtu, duhet theksuar se ndryshe nga Komuna e Podujevës, ajo e Suharekës ka pasur një popullatë më të përzier, si në aspektin etnik, ashtu edhe në atë fetar. Para luftës së vitit 1999, në fshatin Mushtisht dhe disa fshatra tjera të të komunës ka pasur edhe popullatë serbe, ndërsa në fshatin Sallagrazhde kryesisht kanë jetuar shqiptarë të besimit katolik.⁹⁰ Mirëpo, duhet theksuar se përkundër diversitetit të këtillë, gjatë kësaj periudhe marrëdhëniet ndër-etnike dhe ndër-fetare kryesisht kanë qenë të mira.

⁸⁸ Intervistë Imamin 2 të Komunës së Podujevës, 09 gusht 2018.

⁸⁹ Mentor Gjergjaj, "Shteti ua pezulloi sërish punën 16 organizatave që dyshohen për lidhje me grupe radikale," Gazeta Express, 09 janar 2017, <https://www.gazetaexpress.com/lajme/shteti-ua-pezulloi-serish-punen-16-organizatave-qe-dyshohen-per-lidhje-me-grupe-radikale-dokument-304696/?archive=1>

⁹⁰ Intervistë me Zt. Bali Muharremaj, Kryetar i Komunës së Suharekës, 30 gusht 2018.

Ngjashëm me Komunën e Podujevës, edhe në këtë komunë të gjithë të intervistuarit pajtohen se gjatë periudhës së rezistencës paqësore dhe të armatosur të Shqiptarëve ndaj regjimit diskriminues të Millosheviqit (1989–1999), të gjithë banorët shqiptarë të komunës kanë qenë thellësisht të angazhuar për kauzën kombëtare, duke i lënë plotësisht anash çështjet fetare.⁹¹ Për më tepër, popullata në këtë komunë gjithmonë ka pasur ndjenja të fuqishme patriotike, dhe çështja kombëtare ka qenë e përkrahur edhe nga imamët e angazhuar në këto treva.⁹² Pas përfundimit të konfliktit të armatosur në vitin 1999, edhe në Kosovë rrethanat e reja në mënyrë të pashmangshme kanë shkaktuar një proces të transformimit dhe ridefinimit të pozitës së religjionit. Prezenca e Islamit dhe Krishterimit u bënë më të theksuara dhe më të dukshme në të gjitha sferat publike, duke filluar nga jeta personale deri te shoqëria e gjerë, përfshirë edhe politikën. Shumë shpejt, e tërë shoqëria kosovare iu ekspozua një shumëllojshmërie të ideve fetare konkurruese, të cilat në të njëjtën kohë ishin edhe liberale, por edhe konservative.⁹³ Nën petkun e ndihmave humanitare, në Kosovë arritën një varg shoqatash të cilat predikonin forma fetare, si islame ashtu edhe të krishtera që deri atëherë ishin të panjohura për popullatën e Kosovës. Kështu, qytetarët e Kosovës u ballafaquan me forma më radikale të Islamit si Vehabizmi, Salafizmi dhe Vëllazëria Muslimane, por edhe me shoqata me karakter të krishterë katolik, orthodox, evangjelist e të tjerë.⁹⁴

Mirëpo, duhet theksuar se në Komunën e Suharekës procesi i ri-fetarizimit dhe rritjes së praktikimit të fesë ka ndodhur në një shkallë më të ulët se në pjesët tjera të Kosovës. Ngjashëm, përkundër tentativave të organizatave të ndryshme, kryesisht nga shtetet e Gjirit për promovimin e agjendave fetare të Islamit radikal të kamufluara nën petkun humanitar, qytetarët e Suharekës në masë të madhe i kanë refuzuar këto forma radikale të predikimit të Islamit.⁹⁵ Megjithatë, edhe pse në shkallë më të vogël, veprimtaria e këtyre shoqatave ka shkaktuar përçarje edhe mes besimtarëve myslimanë dhe atyre që u përkasin religjioneve të tjera, por edhe brenda vetë myslimanëve, si popullatë bindshëm shumicë në kuadër të komunës.⁹⁶ Format e veprimit të këtyre organizatave

⁹¹ Qëndrimet e këtilla janë konfirmuar unanimisht gjatë shtatë intervistave të zhvilluara me përfaqësues të komunës, partive politike, KBI-së dhe policisë.

⁹² Intervistë me Imamin 2 të Komunës së Suharekës, 30 gusht 2018.

⁹³ Demjaha dhe Peci, 2016, 81.

⁹⁴ Intervistë me Imamin 1 të Komunës së Suharekës, 30 gusht 2018.

⁹⁵ Intervistë me Zt. Bali Muharremaj, Kryetar i Komunës së Suharekës, 30 gusht 2018.

⁹⁶ Intervistë me Imamin 1 të Komunës së Suharekës, 30 gusht 2018.

ishin të shumëllojshme, nga shpërndarja e Kuranit, zhvillimi i ceremonive të synetisë në forma fetare jo-tradicionale, e deri te insistimi i mbulimit të grave me shami, në këmbim të ndihmave humanitare.⁹⁷ Janë shfaqur edhe forma jo-tradicionale të faljes nëpër xhami dhe forma të provokimit të shumicës së xhematit që i kishte mbetur besnik formave tradicionale të predikimit të Islamit. Duhet theksuar se një numër i vogël individësh të cilët i kishin përqaftuar dhe promovuar këto forma radikale të Islamit, kryesisht një gjë të tillë e bënin për përfitime financiare dhe shpesh nuk ishin fare banorë të Komunës së Suharekës.⁹⁸

Pas shpalljes së pavarësisë në vitin 2008, ngjashëm me gjithë territorin e Kosovës, edhe në Komunën e Suharekës, numri i shoqatave të huaja nga vendet Arabe ishte zvogëluar në masë të madhe. Fatmirësisht, në kuadër të komunës nuk ishte krijuar asnjë shoqatë lokale e cila predikonte forma radikale të Islamit. Tendencat për promovimin e formave të tilla jo-tradicionale kryesisht janë bërë nga shoqata nga Komuna e Prizrenit, por edhe nga vendet fqinje. Megjithatë, ndikimi i këtyre shoqatave dhe individëve ka qenë simbolik në gjithë komunën, në rend të parë për shkak të refuzimit nga popullata lokale. Mirëpo, rol të rëndësishëm ka luajtur edhe veprimtaria e KBI-së dhe imamëve lokalë të cilët në vazhdimësi ua kanë shpjeguar qytetarëve rreziqet e formave të këtyra radikale të predikimit të Islamit, dhe njëkohësisht kanë refuzuar çfarëdo lloj bashkëpunimi me këto shoqata dhe individë.⁹⁹ Mirëpo, ekziston mendimi se institucionet shtetërore në nivel qendror nuk kanë reaguar me kohë në parandalimin e veprimtarisë së të gjithave shoqatave dhe individëve që kanë promovuar forma radikale të predikimit të Islamit. Një reagim i tillë ka ndodhur vetëm atëherë kur të rinjtë shqiptarë nga Kosova filluan t'ju bashkohen luftëtarëve të ISIS-it dhe grupeve të tjera në Siri dhe Irak.¹⁰⁰

Të gjithë të intervistuarit në Komunën e Suharekës e theksojnë rolin e pamohueshëm të KBI-së dhe imamëve lokalë në parandalimin e shfaqjes së radikalizmit dhe

⁹⁷ Intervistë me Zt. Sali Asllani, ish Kryetar i Komunës së Suharekës dhe kryetar i degës së LDK-së në Suharekë, 30 gusht 2018.

⁹⁸ Intervistë me Zt. Sali Asllani, ish-kryetar i Komunës së Suharekës dhe kryetar i degës së LDK-së në Suharekë (30 gusht 2018) dhe me Imamin 1 të Komunës së Suharekës (30 gusht 2018).

⁹⁹ Intervistë me Imamin 1 dhe Imamin 2 të Komunës së Suharekës, 30 gusht 2018.

¹⁰⁰ Intervistë me Imamin 1 të Komunës së Suharekës, 30 gusht 2018.

ekstremizmit të dhunshëm në gjithë territorin e komunës.¹⁰¹ Përfaqësuesit e KBI-së që nga fillimi aktivisht janë angazhuar në demaskimin e shoqatave dhe individëve që kanë tentuar promovimin e formave radikale të Islamit në kuadër të komunës. Këto aktivitete janë realizuar nëpër xhami, por edhe gjatë tubimeve të ndryshme, në shkolla dhe në medime. Me këtë rast qytetarëve në mbarë komunën u është shpjeguar se format radikale të Islamit si Vehabizmi, në esencë nuk janë religjion por ideologji. Si të tilla janë tejet të rrezikshme dhe se realisht bëhet fjalë për ideologji që kanë për qëllim shkatërrimin edhe të vetë Islamit. Është shpjeguar edhe roli negativ i ideologjive të tilla përmes mohimit të vlerave kombëtare shqiptare, me çka drejtpërdrejtë është rrezikuar edhe shkatërrimi i kombit. Gjatë gjithë kësaj periudhe, nëpër xhamitë në kuadër të komunës janë identifikuar dhe janë përzënë individët të cilët në çfarëdo mënyre janë munduar të promovojnë forma të këtilla radikale.¹⁰²

Kujdes i veçantë dhe syçeltësi është treguar edhe gjatë procesit të rindërtimit të xhamive të shkatërruara gjatë luftës dhe ndërtimit të xhamive të reja. Në territorin e Komunës së Suharekës nga 24 xhami, 14 prej tyre ishin shkatërruar gjatë luftës. Pas viti 1999, të gjitha këto xhami janë rindërtuar, ndërkaq janë ndërtuar edhe 5 xhami të reja. Gjithë procesi i ndërtimit të xhamive të reja dhe rindërtimit të xhamive të dëmtuara është bërë në mënyrë transparente me kontroll të plotë financiar nga ana e KBI-së. Kryesia e KBI-së i ka refuzuar tentativat dhe ofertat për (ri)ndërtimin e xhamive nga shoqatat e ndryshme të cilat ndihmat financiare i kanë kushtëzuar me emërimin e imamëve të caktuar në ato xhami apo me predikimin e formave jo-tradicionale të Islamit. Financimi i ndërtimit të xhamive të reja është bërë përherë pa kushtëzime dhe përmes transaksioneve të rregullta bankare.¹⁰³

Duhet theksuar se Kryesia e KBI-së në Suharekë ka treguar vendosmëri dhe kujdes të veçantë edhe gjatë emërimit të imamëve në të gjitha xhamitë që funksionojnë në nivel të komunës. Me rastin e këtyre emërimeve, KBI ka qenë jashtëzakonisht e kujdesshme që në kuadër të institucionit të mos pranohen imamë apo nëpunës për të cilët është dyshuar se janë të involvuar në predikimin dhe promovimin e formave jotradicionale të

¹⁰¹ Qëndrimet e këtilla janë konfirmuar unanimisht gjatë shtatë intervistave të zhvilluara me përfaqësues të komunës, partive politike, KBI-së, policisë dhe medimeve.

¹⁰² Intervistë me Imamin 1 dhe Imamin 2 të Komunës së Suharekës, 30 gusht 2018.

¹⁰³ Intervistë me Imamin 1 të Komunës së Suharekës, 30 gusht 2018.

Islamit. Ka pasur raste kur kjo politikë konsekuente e emërimit të imamëve është kundërshtuar nga Kryesia Qendrore e BIK-ut, duke shkaktuar ndonjëherë edhe tensione mes KBI-së dhe BIK-ut.¹⁰⁴ Kujdes të veçantë kryesia e KBI-së rregullisht i ka kushtuar edhe kontrollimit të predikimit të imamëve të saj për t'u siguruar se nuk bëhet fjalë për forma radikale të predikimeve që janë në kundërshtim me Islamin tradicional dhe të preferuar nga KBI. Poashtu, menjëherë pas përfundimit të konfliktit në vitin 1999, KBI-ja ka marrë vendim që imamët e angazhuar në kuadër të Këshillit të refuzojnë çfarëdo lloj bashkëpunimi me shoqatat apo individët që promovojnë forma radikale të predikimit të Islamit.¹⁰⁵

Vëmendje të posaçme dha angazhim maksimal kryesia e KBI-së në Komunën e Suharekës ka treguar edhe lidhur me parandalimin e depërtimit dhe veprimit të shoqatave nga Lindja e Mesme me karakter Vehabist, Salafist dhe të Vëllazërisë Myslimane. Pikërisht falë veprimtarisë së KBI-së në këtë drejtim, shoqatat e këtilla edhe përkundër përpjekjeve sidomos gjatë fazës së hershme të pasluftës, në këtë komunë nuk kanë arritur të gjejnë terren të përshtatshëm për promovimin e formave radikale të predikimit të Islamit.¹⁰⁶ Në të njëjtën kohë, në Komunën e Suharekës këto organizata nuk kanë arritur të gjejnë as bashkëpunëtorë të brendshëm, siç ka ndodhur në komunitet tjera në Kosovë. Në të vërtetë, aktualisht në kuadër të komunës nuk vepron asnjë OJQ që propagon forma radikale të Islamit. Në të kaluarën ka pasur tentativa të tilla, kryesisht të organizatave nga Prizreni, mirëpo përfaqësuesit e këtyre organizatave janë larguar nga policia me kërkesë të KBI-së komunale meqenëse kanë vepruar jashta rregullave të BIK-ut.¹⁰⁷ KBI dhe imamët lokalë aktivisht kanë vepruar me qëllim të demaskimit të këtyre ideologjive radikale në sytë e qytetarëve.

Angazhim i veçantë është bërë edhe nëpër shkolla për t'ju shpjeguar nxënësve rreziqet që sjellin ideologjitë e këtilla përmes insistimit në forma radikale të predikimit, cënimit të vlerave dhe simboleve kombëtare, e deri te mbulimi i vajzave me shami.¹⁰⁸ Gjatë këtyre

¹⁰⁴ Intervistë me Imamin 1 dhe Imamin 2 të Komunës së Suharekës, 30 gusht 2018.

¹⁰⁵ Intervistë me Imamin 1 të Komunës së Suharekës, 30 gusht 2018.

¹⁰⁶ Ibid.

¹⁰⁷ Intervistë me Zt. Milazim Lumi, Komandant i policisë në Komunën e Suharekës, 18 tetor 2018.

¹⁰⁸ Vlen të përmendet se numri i grave apo vajzave të mbuluara në Komunën e Suharekës është tejet i vogël. Intervistë me Zt. Bali Muharremaj, Kryetar i Komunës së Suharekës dhe Zt. Sali Asllani, ish-kryetar i Komunës së Suharekës dhe kryetar i degës së LDK-së në Podujevë, 30 gusht 2018.

aktiviteteve për pengimin e veprimtarisë së këtyre shoqatave, përfaqësuesit e KBI-së shpesh edhe janë kërcënuar nga grupet dhe individët radikalë, mirëpo atyre ju kanë dalur në mbrojtje jo vetëm policia, por edhe vetë qytetarët.¹⁰⁹ Madje, mund të konstatohet se në Komunën e Suharekës, rol të rëndësishëm në parandalimin e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm kanë luajtur pikërisht qytetarët në gjithë territorin e komunës, sepse ata jo vetëm se nuk i kanë përkrahur tentativat për aktivitete që çojnë drejt radikalizmit, por drejtpërdrejtë kanë ndihmuar në identifikimin e grupeve dhe individëve që kanë tentuar të predikojnë forma radikale të Islamit.¹¹⁰ Për shembull, në njërin nga fshatrat e komunës, individë të caktuar kanë tentuar t'i thërrasin nxënësit që nga shkolla të shkojnë në xhami për orë fetare, mirëpo drejtori i shkollës, mësimdhënësit, por edhe prindërit e kanë refuzuar një gjë të tillë. Me këtë rast, mesazhi i dhënë qartë nga të gjithë përfaqësuesit shoqërorë ka qenë se në këtë trevë nuk ka hapësirë për predikim të formave radikale të Islamit, përveç atij tradicional.¹¹¹

Ngjashëm me Komunën e Podujevës, edhe në atë të Suharekës bashkëpunimi me autoritetet komunale ka qenë në nivel të lartë. Pushteti lokal gjithmonë ka qenë vigjilent në parandalimin e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm. Kanë ekzistuar kontakte dhe bashkëpunim i vazhdueshëm në mes të përfaqësuesve të pushtetit lokal dhe KBI-së në Suharekë, me qëllim të luftimit të formave radikale të predikimit të Islamit.¹¹² Një shembull konkret i një bashkëpunimi të këtillë është rasti i ndërtimit të xhamisë së re në fshatin Dubravë. Para fillimit të ndërtimit, kanë reaguuar banorët, por edhe tre anëtarë të Asamblesë Komunale nga ky fshat, me pretekst se ndërtimi planifikohet të bëhet nga individë të dyshimtë. Për të zgjidhur këtë çështje, autoritetet komunale kanë organizuar referendum me banorët e fshatit enkas për këtë çështje. Vetëm pas deklarimit të shumicës së banorëve në favor të ndërtimit të xhamisë është lejuar ndërtimi i saj.¹¹³ Bashkëpunimi ka qenë në nivel të kënaqshëm edhe në relacionin mes KBI-së dhe Policisë së Kosovës. Çdo herë kur ka pasur reagim/informatë nga ana e

¹⁰⁹ Intervistë me Imamin 1 të Komunës së Suharekës, 30 gusht 2018.

¹¹⁰ Intervistë me Zt. Shpëtim Ndrecaj, Drejtor i Radio Vala në Suharekë, 18 tetor 2018.

¹¹¹ Intervistë me Zt. Blerim Xhemajlin, kryetar i degës së PDK-së në Podujevë, 17 tetor 2018.

¹¹² Intervistë me Zt. Bali Muharremaj, Kryetar i Komunës së Suharekës (30 gusht 2018) dhe Blerim Xhemajlin, kryetar i degës së PDK-së në Podujevë (17 tetor 2018).

¹¹³ Vlen të përmendet se në këtë xhami sot shkon një numër tejet i vogël i besimtarëve. Intervistë me Zt. Sali Asllani, ish-kryetar i Komunës së Suharekës dhe kryetar i degës së LDK-së në Podujevë (30 gusht 2018) dhe me Zt. Shpëtim Ndrecaj, Drejtor i Radio Vala në Suharekë (18 tetor 2018).

KBI-së për dyshime të predikimit të formave radikale të Islamit, policia menjëherë ka dalur në vendin e ngjarjes dhe ka reaguar në mënyrë profesionale. Kështu, në fshatin Grejkoc ka pasur indikacione se imami po predikon forma jo-tradicionale të Islamit, përfshi edhe një mënyrë ndryshe të faljes së namazit. Policia ka reaguar menjëherë duke dërguar policë civilë për ta vëzhguar situatën. Megjithatë, problemi është zgjidhur pa ndërhyrjen e policisë, meqë me kërkesën e qytetarëve, imami në fjalë është shkarkuar nga KBI dhe është zëvendësuar me një tjetër.¹¹⁴ Vlen të përmendet, se bashkëpunimi në trekendëshin KBI – Pushtet Lokal – Polici, ka qenë i vazhdueshëm, mes tjerash edhe në takimet e rregullta të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi. Në mbledhjet e këtij Këshilli, ku secili nga tri institucionet e lartpërmendura i ka përfaqësuesit e vetë, rregullisht është diskutuar për rreziqet eventuale nga radikalizmi dhe ekstremizmi i dhunshëm, si dhe për mënyrat më efikase për ballafaqimin me to.¹¹⁵ Mund të konstatohet se, ngjashëm me Komunën e Podujevës, edhe në Suharekë, bashkëpunimi i suksesshëm mes autoriteteve lokale fetare, pushtetit lokal dhe policisë paraqet një nga faktorët kyq për parandalimin e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm.¹¹⁶

Në përgjithësi fitohet përshtypja se për dallim nga komunat tjera anembanë Kosovës, në Suharekë partitë politike nuk kanë koketuar me grupe dhe individë që promovojnë forma radikale të Islamit me qëllim të sigurimit të votave. Për më tepër, sidomos gjatë viteve të hershme të pasluftës së vitit 1999, LDK ka qenë aktivisht e angazhuar në promovimin e tolerancës fetare dhe vlerave perëndimore.¹¹⁷ Nga ana tjetër, partia AAK, ngjashëm me territoret tjera në Kosovë, ka refuzuar bashkëpunimin me strukturat e lartpërmendura dhe është angazhuar për promovimin e vlerave kombëtare dhe pro-perëndimore.¹¹⁸ Edhe partitë tjera aktive në komunë, në përgjithësi kanë bashkëpunuar në parandalimin e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm në territorin e komunës përmes takimeve në Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi dhe diskutimeve lidhur

¹¹⁴ Intervistë me Zt. Milazim Lumi, Komandant i policisë në Komunën e Suharekës, 18 tetor 2018.

¹¹⁵ Intervistë me Zt. Bali Muharremaj, Kryetar i Komunës së Suharekës, 30 gusht 2018.

¹¹⁶ Intervistë me Blerim Xhemajlin, kryetar i degës së PDK-së në Podujevë, 17 tetor 2018.

¹¹⁷ Intervistë me Zt. Sali Asllani, ish-kryetar i Komunës së Suharekës dhe kryetar i degës së LDK-së në Podujevë, 30 gusht 2018.

¹¹⁸ Duhet theksuar se viteve të fundit edhe LDK edhe AAK kanë lejuar infiltrimin e individëve që promovojnë forma radikale të Islamit. Raste të këtilla kemi në Komunën e Gjilanit që udhëhiqet nga LDK, por edhe në ate të Deçanit që udhëhiqet nga AAK. Intervistë me Zt. Bali Muharremaj, Kryetar i Komunës së Suharekës nga rradhët e AAK-së, 30 gusht 2018.

me këto tema. Fitohet përshtypja se për shkak të faktit se qytetarët e komunës në masë të madhe i kanë refuzuar format radikale të Islamit, partitë më të mëdha politike që veprojnë në komunë nuk pasur nevojë të koketimit dhe bashkëpunimit me shoqatat dhe individët që i promovojnë format e tilla. Madje kandidatët e Partisë së Drejtësisë për zgjedhje lokale në kuadër të komunës rregullisht kanë marrë një numër tejet simbolik të votave.¹¹⁹

Në përgjithësi, bashkëpunimi lidhur me parandalimin e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm ka qenë në nivel të kënaqshëm edhe në relacionin mes mediave lokale dhe KBI-së në nivel komunal. Ngjashëm me Komunën e Podujevës, edhe në atë të Suharekës, përfaqësues të KBI-së shpesh janë paraqitur në mediumet lokale për të sqaruar dëmet e ideologjive radikale që kanë predikuar forma jo-tradicionale të Islamit.¹²⁰ Mirëpo duhet theksuar, se përfaqësuesit e medimeve lokale kanë qenë syçelë për mos t'ju lejuar grupeve apo individëve të caktuar shfrytëzimin e medimeve për promovimin e formave radikale të predikimit. Konkretisht, kërkesat e tilla u janë refuzuar dy individëve nga Maqedonia, por edhe një imami nga Suhareka që njihet për predikim të formave jo-tradicionale të Islamit. Në të njejtën kohë, në valët e radios lokale është promovuar fryma e tolerancës dhe bashkëpunimit ndër-fetar duke ftuar njëkohësisht në studio përfaqësues të KBI-së, të Kishës Katolike dhe asaj Protestante.¹²¹

Mirëpo, edhe pse jo në masë të madhe, kohëve të fundit ka fakte që flasin për prezencën e elementeve radikale edhe në Komunën e Suharekës. Ky realitet kryesisht ndërlihdet me ndryshimet tanimë të përmendura që janë bërë në Rregulloren e BIK-ut lidhur me emërimin e imamëve në të gjitha komunat në Kosovë. Para këtyre ndryshimeve të Rregullores, imamët në kuadër të komunës janë emëruar me propozim të drejtëpërdrejtë nga kryesia e KBI-së dhe vetëm janë aprovuar nga BIK-u. Me rregulloren e re, emërimi i imamëve nëpër komuna bëhet drejtëpërdrejtë nga ana e BIK-ut, ndërkaq KBI-të kanë vetëm rol këshilldhënës.¹²² Si rezultat, në Komunën e Suharekës tanimë janë bërë disa emërimë të imamëve të cilët predikojnë forma radikale të Islamit, të ndryshme nga format tradicionale tolerante karakteristike për Kosovën. Kështu, për shkak të

¹¹⁹ Intervistë me Zt. Shpëtim Ndrecaj, Drejtor i Radio Vala në Suharekë, 18 tetor 2018.

¹²⁰ Intervistë me Imamin 1 të Komunës së Suharekës, 30 gusht 2018.

¹²¹ Intervistë me Zt. Shpëtim Ndrecaj, Drejtor i Radio Vala në Suharekë, 18 tetor 2018.

¹²² Intervistë Imamin 2 të Komunës së Suharekës, 30 gusht 2018.

mosmarrëveshjeve në realcionin KBI-BIK, në xhaminë e vetme që funksionon në qytetin e Suharekës aktualisht predikojnë dy imamë. Një javë një imam i predikon format e besimit tradicional, ndërkaq javën tjetër predikon imami tjetër i cili konsiderohet i afërt me ideologjitë radikale të Islamit.¹²³ Kjo zgjidhje paraqet një lloj kompromisi pas mosmarrëveshjeve mes KBI-së dhe BIK-ut në Prishtinë. Poashtu, në xhaminë e fshatit Samadrexhë, përkundër vërejtjeve nga KBI-ja, BIK-u e ka emëruar një imam për të cilin ekzistojnë dyshime serioze se predikon forma radikale të Islamit.¹²⁴ Vazhdimi i një praktike të këtillë të emërimit të imamëve nga BIK-u që predikojnë forma radikale të Islamit, padyshim se mund të çojë deri te rritja e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm në këtë komunë. Megjithatë, mbetet si ngushëllim fakti se banorët e Komunës së Suharekës në vazhdimësi i kanë refuzuar format radikale të predikimit të Islamit dhe i kanë mbetur besnik kombit shqiptar dhe qëndrimit pro-perëndimor dhe pro-amerikan.¹²⁵

¹²³ Intervistë me Zt. Shpëtim Ndrecaj, Drejtor i Radio Vala në Suharekë, 18 tetor 2018.

¹²⁴ Intervistë Imamin 1 të Komunës së Suharekës, 30 gusht 2018.

¹²⁵ Intervistë me Blerim Xhemajlin, kryetar i degës së PDK-së në Podujevë, 17 tetor 2018.

4. Përfundime dhe Rekomandime

Pas sulmeve terroriste në disa qytete të Evropës, parandalimi i radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm është bërë prioritet në agjendat politike të shumicës së qeverive në botë. Në vitin 2011, Kosova u rangua ndër vendet me përqindjen më të lartë për kokë të banorëve për nga numri i luftëtarëve të huaj në luftërat në Siri dhe Irak. Hulumtimet e shumta të realizuara ndërkohë poashtu flasin për një nivel relativisht të lartë të radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm në rajone të caktuara të vendit. Për deri sa në disa komuna, sikurse në ato të Kaçanikut dhe Hanit të Elezit është evidentuar një numër relativisht i lartë i luftëtarëve të huaj, në ato të Podujevës dhe Suharekës ky numër është tejet i vogël apo joegzistues. Realiteti i njejtë është edhe sa i përket nivelit të radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm. Prandaj, qëllimi kryesor i këtij punimi ishte të hulumtojë faktorët që kontribuan në parandalimin e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm në këto dy komuna.

Për vite me rradhë, faktorët socio-ekonomikë janë konsideruar ndër shkaktarët kryesorë të radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm në Kosovë. Me qëllim të analizës së ndikimit të faktorëve socio-ekonomikë në shfaqjen e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, gjatë hulumtimit është bërë krahasimi i këtyre të dhënave për komunat e Podujevës dhe Suharekës me nivel të ultë të radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm dhe atyre të Kaçanikut dhe Hanit të Elezit, ku niveli i këtyre fenomeneve negative është mjaft i lartë. Përveç qëllimit për të vërtetuar se vallë ka dallime të konsiderueshme të këtyre karakteristikave mes këtyre dy grupeve të komunave, hulumtimi poashtu ka tentuar të vërtetojë nëse ekziston një korrelacion midis këtyre karakteristikave dhe shfaqjes së radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm. Për këtë qëllim janë analizuar të dhënat për: popullatën dhe lëvizjet demografike, nivelin e arsimit në komuna, religjionin duke përfshirë objektet religjioze dhe klerikët fetarë, personat që kanë marrë pjesë në luftrat në Siri dhe Irak, nivelin e kriminalitetit, gjendjen ekonomike, si dhe buxhetin komunal, me theks të posaçëm në shpenzimet kapitale si dhe shpenzimet dhe subvencionet për rini. Grupmohës prej 15 deri 29 vjet i është kushtuar një vëmendje e veçantë sepse janë pikërisht të rinjtë e kësaj moshe ata/ato që kanë qenë më së shumti të prekur nga dukuria e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm.

Krahasimi i të gjitha këtyre të dhënave socio-ekonomike për të katër komunat ka treguar se nuk ka dallime të mëdha në asnjërin nga kategoritë e të dhënave të analizuarra mes komunave të Podujevës dhe Suharekës në njërin anë, dhe atyre të Kaçanikut dhe Hanit të Elezit, në anën tjetër. Rrjedhimisht, është përfunduar se nuk ekziston ndonjë korrelacion i qartë midis këtyre karakteristikave socio-ekonomike dhe nivelit të shfaqjes së radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm në këto katër komuna. Këto rezultate e kanë sfiduar qartë paradigmen socio-ekonomike të shpjegimit të shfaqjes së mostolerancës fetare dhe ekstremizmit të dhunshëm, por nuk kanë dhënë përgjigje në pyetjen - përse në komunat e Podujevës dhe Suharekës niveli i radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm është shumë më i ulët se në disa komuna të tjera? Për t'ju përgjigjur kësaj pyetje është shtruar nevoja për një analizë më të thellë e cila i merr parasysh rrethanat specifike të këtyre dy komunave.

Në bazë të kësaj analize mund të përfundohet se faktori kryesor që ka kontribuar në parandalimin e shfaqjes së radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm në këto dy komuna është veprimi i drejtë dhe i duhur nga ana e Këshillit të Bashkësisë Islame (KBI). Në të dy rastet, KBI-të në fjalë që nga fillimi i kanë rezistuar instalimit të organizatave dhe individëve që kanë insistuar në predikimin e formave radikale të Islamit. Vazhdimisht është biseduar me popullatën, dhe atë jo vetëm në xhami gjatë namazit, por edhe gjatë tubimeve, nëpër shkolla dhe në medime. Janë demaskuar ideologjitë e këtyra radikale si të huaja dhe të dëmshme për shqiptarët në Kosovë. Rrjedhimisht, në këto dy komuna, shoqatat e këtyra edhe përkundër përpjekjeve sidomos gjatë fazës së hershme të pasluftës, në këtë komunë nuk kanë arritur të gjejnë terren të përshtatshëm për promovimin e formave radikale të predikimit të Islamit. Në të njëjtën kohë, në këto dy komuna këto organizata nuk kanë arritur të gjejnë numër të mjaftueshëm të bashkëpunëtorëve të brendshëm, siç ka ndodhur në komunat tjera në Kosovë. Njëkohësisht, mund të përfundohet se KBI-të në të dy komunat kanë treguar vëmendje të posaçme dhe guxim gjatë procesit të emërimit të imamëve. Përkundër kontestimeve dhe kundërshtimeve nga Kryesia Qendrore e Bashkësisë Islame të Kosovës (BIK), madje edhe tensioneve serioze në drejtimin KBI – BIK, KBI-të në të dy komunat kanë refuzuar emërimin e cilitdo imam apo nëpunës për të cilët kanë ekzistuar dëshmi se kanë qenë të involvuar në predikimin e formave radikale të Islamit. Poashtu, KBI-të komunale në Podujevë dhe Suharekë vazhdimisht i kanë refuzuar

ofertat e shumta nga organizatat e huaja për ndërtimin e xhamive të reja apo rindërtimin e xhamive të shkatërruara gjatë luftës, në rast se ky proces i (ri)ndërtimit ka qenë i kushtëzuar me emërimin e imamëve të caktuar në këto xhami apo me insistimin që në këto objekte fetare të predikohen forma radikale të Islamit.

Poashtu, mund të konkludohet se numri më i madh i xhamive të reja të ndërtuara nuk është barometër i matjes së nivelit të radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm. Në këtë drejtim, shumë më e rëndësishme është se nga cilat organizata është financuar ndërtimi i xhamive të reja, a është bërë ky ndërtim me leje të KBI-së komunale dhe vallë këto organizata e kanë kushtëzuar ndërtimin e xhamive me emërimin e imamëve të caktuar apo kanë insistuar që në këto objekte fetare të predikohen forma radikale të Islamit. Njëkohësisht, element mjaft i rëndësishëm është fakti se vallë KBI-të në nivel komunal kanë bashkëpunuar me përfaqësuesit e “shoqerisë civile religjioze” me karakter radikal apo i kanë kundërshtuar shoqatat e tilla dhe kanë refuzuar çfarëdo bashkëpunimi me to. Nga ana tjetër, nga analiza e bërë, mund të konstatohet se nuk qëndron spjegimi nga disa qarqe se arsyeja pse radikalizmi dhe ekstremizmi i dhunshëm nuk ka arritur të lëshojë rrënjë në rajonin e Llapit ka të bëjë me faktin se popullata në atë pjesë të Kosovës ka qenë gjithmonë më fetare se qytetarët në pjesët tjera të vendit. Marrë këtë parasysh, gjithsesi arsyet për mos shfaqjen e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm në Komunën e Podujevës, por edhe në atë të Suharekës banorët e së cilës tradicionalisht ka qenë më pak fetarë, duhet kërkuar tek faktorë të tjerë.

Në bazë të hulumtimit mund të përfundohet se një nga faktorët tjerë të rëndësishëm për parandalimin e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm në këto dy komuna ka qenë edhe bashkëpunimi i suksesshëm mes autoriteteve lokale fetare, pushtetit lokal dhe policisë. Ekzistojnë shembuj të shumtë kur përmes koordinimit të përbashkët të KBI-së, autoriteteve lokale dhe policisë është penguar ndërtimi i ndonjë xhamije pa leje, janë parandaluar veprimet e grupeve për predikim radikal të Islamit ose edhe janë burgosur pjesëtarët e këtyre grupeve. Sa i përket rolit të partive politike në parandalimin e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm situata në të dy komunat dallon deri diku. Në Komunën e Podujevës, përveç disa përjashtimeve të vogla, partitë politike gati aspak nuk kanë vepruar në parandalimin e këtyre dukurive negative dhe madje gjatë fushatave zgjedhore, me qëllim të sigurimit të votave, disa prej tyre kanë koketuar dhe

bashkëpunuar me grupe dhe individë të caktuar që kanë qenë të involvuar në përhapjen e formave radikale të Islamit. Nga ana tjetër, në Komunën e Suharekës partitë politike nuk kanë koketuar me grupe dhe individë që promovojnë forma radikale të Islamit me qëllim të sigurimit të votave. Përkundrazi, shpesh kanë qenë aktivisht të angazhuar në promovimin e tolerancës fetare dhe vlerave perëndimore qoftë në mënyrë individuale, qoftë përmes takimeve në Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi dhe diskutimeve lidhur me këto tema. Njëkohësisht, mund të konstatohet se bashkëpunimi lidhur me parandalimin e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm ka qenë në nivel të kënaqshëm edhe në relacionin mes mediave lokale dhe KBI-së në të dy komunat. Shpesh, përfaqësues të KBI-së janë paraqitur në mediumet lokale për të sqaruar dëmet e predikimeve radikale të Islamit që kanë tentuar të infiltrohen në territorin e komunës. Përmes debateve dhe ligjëratave këta përfaqësues fetarë kanë shpërndarë njohuri të sakta për Islamin dhe gjithashtu e kanë spjeguar të vërtetën lidhur me lëvizjet e reja me karakter radikal.

Mirëpo, ekzistojnë indikacione se kohëve të fundit situata në Komunën e Suharekës, por sidomos në atë të Podujevës, ka filluar të përkeqësohet sa i përket radikalizmit dhe ekstremizmit fetar. Ky realitet kryesisht ndërlidhet me ndryshimet që janë bërë në KBI në kuadër të komunës, si dhe ndryshimeve në Rregulloren e BIK-ut lidhur me emërimin e imamëve në të gjitha komunat në Kosovë. Për deri sa para ndryshimeve të fundit të Rregullores, imamët në kuadër të komunës janë emëruar me propozim të drejtëpërdrejtë nga kryesia e KBI-së, me ndryshimet e fundit, të gjitha ingerencat për emërimin e imamëve nëpër komuna kanë kaluar në duart e BIK-ut. Marrë parasysh se në kryesinë e BIK-ut tanimë ka individë me pikëpamje radikale, ekziston rreziku që në të dy komunat, por edhe në mbarë Kosovën, të emërohen imamë të cilët predikojnë forma radikale të Islamit, të ndryshme nga format tradicionale tolerante karakteristike për Kosovën. Si pasojë, përkundër kundërshtimeve nga KBI-të, në të dy komunat tanimë janë bërë disa emërimet të imamëve të cilët propagojnë ideologjitë radikale të Islamit. Vazhdimi i një praktike të këtillë të emërimit të imamëve të radikalizuar nga ana e BIK-ut, padyshim se mund të çojë deri te rritja e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm në këto komuna. Një shpresë në këtë drejtim është fakti se qytetarët në të dy komunat nuk i kanë përkrahur tentativat për aktivitete që çojnë drejt radikalizmit, dhe madje drejtëpërdrejtë kanë ndihmuar në identifikimin e grupeve dhe individëve që kanë tentuar të predikojnë forma radikale të Islamit. Mirëpo, mbetet diskutabile se në

ç'mënyrë do të sillej popullata lokale sikur përfaqësuesit e KBI-së në të dy komunat prej fillimit të mos ishin angazhuar maksimalisht në parandalimin e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm.

Rekomandime:

- Institucionet qeveritare, udhëheqësit politikë dhe ata fetarë, duhet që të prezantojnë një diskurs të përbashkët publik në Kosovë i cili do të promovonte format tradicionale tolerante të Islamit dhe do të dënonte format e huaja radikale që padyshim çojnë drejt radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm.
- Bashkësia Islame e Kosovës duhet ta ndërprejë emërimin e imamëve radikalë nëpër xhamitë e saj. Gjatë emërimit të imamëve, BIK-u duhet të bashkëpunojë ngushtë me përfaqësuesit e KBI-ve komunale sidomos në ato komuna si ajo e Podujevës dhe Suharekës që deri më tani kanë shfaqur nivele të ulta të radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm.
- Duhet të sigurohet një bashkëpunim intenziv dhe i vazhdueshëm në mes të përfaqësuesve të pushtetit lokal, KBI-ve komunale dhe policisë për parandalimin e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm në nivel të çdo komune.
- Autoritetet e pushtetit lokal në bashkëpunim me pushtetin qendror duhet dukshëm t'i rrisin investimet kapitale dhe përkrahjen e kulturës, rinisë dhe sportit, veçanërisht ato për infrastrukturën dhe aktivitetet që ndërlidhen me rini.
- Partitë politike, si në nivelin qendror ashtu edhe në atë lokal, duhet të veprojnë bashkarisht në demaskimin e formave radikale të predikimit të Islamit dhe në luftimin e grupeve dhe individëve që i promovojnë format e tilla, dhe duke e respektuar lirinë e shprehjes dhe të drejtën e patjetërsueshme në besimin fetar, si e drejta elementare njerëzore.
- Sistemi i drejtësisë i Kosovës duhet të zbatojë vendosshmërisht kornizën ligjore (Kodin Penal) ndaj gjuhës së urrejtjes, për sa i përket urrejtjes fetare dhe etnike, si dhe predikimit të ekstremizmit.

- Mediumet elektronike në Kosovë, si në nivelin qendror ashtu edhe në atë lokal, duhet të ofrojnë skema programore që promovojnë tolerancë dhe bashkëjetesë fetare dhe mos t'ju japin hapësirë individëve të cilët përdorin gjuhën e urrejtjes ndër-fetare dhe ndër-etnike.

Consortium: "With Participatory Democracy for a Kosovo without Radicalization" | Konzorciumi: "Me Demokraci Pjesëmarrëse për një Kosovë pa Radikalizim"

